



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT
(Përfundimtar)

PËR
MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL
BASHKIA LEZHË

Tiranë, Prill 2025

RAPORT

Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Lezhë

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes dhe të urdhrit nr. 121, datë 20.12.2024, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Lezhë”*, ka filluar mbikëqyrjen me objekt zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimi në shërbimin civil; lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike për administrimin e këtij procesi.

Mënyra e funksionimit të njësive të vetëqeverisjes vendore, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse, janë të rregulluara me ligjin nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*. Sipas këtij ligji, njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë bashkitë dhe qarqet, të cilat realizojnë vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 6 dhe 65 të këtij ligji, përcaktohet se: *“Bashkia përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale. Njësitë administrative në territorin e një bashkie, shtrirja e tyre territoriale dhe emri, përcaktohen me ligj”*;

“Struktura dhe organika e administratës së njësive administrative janë pjesë të strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë”.

Në rastin konkret, Bashkia Lezhë në përbërje të saj ka dhe njësitë administrative, Shëngjin, Shënkoll, Zejmen, Kolsh, Balldre, Blinisht, Dajç, Kallmet dhe Ungrej, të përcaktuar në ligjin nr.115/2014 *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*. Struktura dhe organika e këtyre njësive administrative, janë pjesë përbërëse e strukturës dhe organikës së administratës së Bashkisë Lezhë e në këto rrethana, kryerja e mbikëqyrjes është shtrirë edhe në njësitë administrative.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt u realizua sipas Programit të Mbikëqyrjes nr. 942/1 Prot., datë 20.12.2024, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Lezhë me shkresën nr. 942/2 Prot., datë 20.12.2024, *“Njoftim për fillimin*

e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Lezhë”. Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrjes në datën 13.01.2025.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës, i përbërë nga inspektorët Antea Kabali dhe Françeska Doksani, nën drejtimin e Drejtorit të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ Luiseda Zhapa, përpunoi të dhënat dhe përgatiti raportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Lezhë.

Ky material, u dërgua për njohje, me shkresën nr. 410 prot., datë 25.03.2025, pranë institucionit, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet e tyre në lidhje me gjetjet e grupit të punës.

Pas kësaj, me shkresën nr. 3914/1 prot., datë 04.04.2025, institucioni ka dërguar të nënshkruar projektraportin së bashku me observacionet përkatëse, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes, si dhe reflektuar në rubrikën përkatëse.

Qëllimi i mbikëqyrjes:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

DREJTIMET E MBIKËQYRJES:

Mbikëqyrja është orientuar drejt verifikimit të situatës së administrimit të shërbimit civil në këtë institucion, për të arritur në konkluzion se si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me respektimin e skemës së administrimit të shërbimit civil, si dhe të procedurave që ndiqen gjatë aplikimit të instituteve të ligjit, duke u fokusuar konkretisht:

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë aplikimit në praktikë të procesit të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.
2. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.

3. Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, nëpërmjet konkurrimit dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 22 dhe akteve nënligjore në lidhje me dy fazat e këtij procesi:
 - verifikimi paraprak nga njësia përgjegjëse, nëse konkurrentët i plotësojnë kërkesat e përgjithëshme dhe të veçanta të vendit të punës;
 - vlerësimi i kandidatëve nga Komiteti i Përhershëm i Pranimi.
4. Emërimet në shërbimin civil pas përfundimit të procesit të konkurrimit dhe menaxhimi i listës së kandidatëve fitues që kanë arritur pikët, por që nuk janë emëruar. Evidentimi i rasteve të emërimit pa konkurrim, në kundërshtim me kërkesat e nenit 23 të ligjit për nëpunësin civil.
5. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës *(si janë zbatuar detyrimet e nëpunësit dhe eprorit si dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe)*.
6. Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive dhe respektimi i kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 25 të ligjit për nëpunësin civil, gjatë zhvillimit të kësaj procedure nga Komisioni i Brendshëm.
7. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese dhe respektimi i procedurave të kërkuara nga neni 26 i ligjit për nëpunësin civil, nga njësia përgjegjëse dhe Komiteti i Pranimi gjatë zhvillimit të dy fazave të konkurrimit:
 - verifikimit paraprak;
 - vlerësimi i kandidatëve.
8. Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese dhe respektimi i kërkesave të nenit 32 të ligjit për nëpunësin civil nga ana e titullarit të institucionit *(respektimi i kufirit prej 15% të pranimi nga jashtë shërbimit civil)*; respektimi i kërkesave ligjore nga ana e njësisë përgjegjëse për organizimin e konkurrimit dhe respektimi i procedurave të konkurrimit nga ana e Komisionit të Përhershëm të Pranimi, gjatë realizimit të procesit.
9. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar.
10. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore, duke filluar nga kërkesa për nisjen e ecurisë disiplinore, deri në marrjen e vendimit përfundimtar, sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014.

Aktet administrative që janë kërkuar për tu vënë në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes, janë konkretisht:

1. Struktura organizative dhe analitike aktuale e institucionit.
2. Listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve të institucionit për muajin Dhjetor 2024.

3. Akti i deklarimit të statusit të nëpunësit civil për shkak të ligjit, për punonjësit aktual të institucionit, nëse ka.
4. Formulari i përshkrimit të punës për çdo pozicion që është përfshirë në procesin e plotësimit të vendeve të lira nëpërmjet pranimit nga jashtë në nivelin ekzekutiv, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë.
5. Materialet që dokumentojnë procesin e rekrutimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.
 - Plani vjetor i rekrutimit dhe paqyrimi i nevojës për rekrutim nga jashtë shërbimit civil për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues (20%) dhe të lartë drejtues (15%).
 - Shpallja e vendit të lirë (*grup pozicionesh –nivel ekzekutiv/pozicion për ngritje në detyrë -nivel i lartë drejtues/nivel i ulët ose i mesëm drejtues*).
 - Kërkesa dërguar AKPA/shpallja në faqen e internetit të institucionit.
 - Aktet që vërtetojnë respektimin e afateve në shpallje (*sipas aktit nënligjor dhe udhëzimit të DAP*).
 - Aktet që materializojnë përbërjen e Komisionit të Përhershëm të Pranimit - për nivelin ekzekutiv.
 - Aktet që materializojnë procedurat e ndjekura për fazën e verifikimit paraprak:
 - Lëvizje paralele nivel ekzekutiv (*dërgimi për publikim në AKPA*);
 - Lëvizje paralele në nivelin e mesëm dhe të ulët (*dërgimi për publikim në AKPA*);
 - Lista e kandidatëve të skualifikuar – arsyet dhe komunikimi me ta;
 - Ankimimi;
 - Aktet që materializojnë procesin e pranimit në shërbimin civil:
 - verifikimi paraprak/verifikimi përfundimtar mbas ankimimit (*nëse ka dhe dërgimi për publikim*) në nivel ekzekutiv;
 - procesverbli i prezencës në testimin me shkrim;
 - hartimi i tezës nga KPP /sekretimi;
 - procesverbali i prezencës në intervistën me gojë;
 - verifikimi i përgjigjeve të dhëna nga kandidatët e kualifikuar për testimin me shkrim; pyetjet e përzgjedhura nga KPP për këtë fazë;
 - pyetjet e intervistes me gojë;
 - deklarata e regjistrimit audio;
 - deklarata e paanësisë së KPP;
 - raporti i KPP për rezultatet (*para ankesave*);
 - vendimi për rezultatin përfundimtar të kandidatit fitues;
 - shpallja e fituesit në AKPA;
 - deklarata e pranimit të pozicionit – regjistrimi në listën e fituesve të atyre që nuk pranojnë pozicionin;
 - procedura e ankimimit nëse ka;
 - Aktet që materializojnë procesin e ngritjes në detyrë:
 - akti që materializon ngritjen e Komitetit të Pranimit;
 - verifikimi paraprak/verifikimi përfundimtar mbas ankimimit (*nëse ka dhe dërgimi për publikim*);

- procesverbali i prezencës në testimin me shkrim;
 - hartimi i tezës nga KPND /sekretimi;
 - procesverbali i prezencës në intervistën me gojë;
 - pyetjet e intervistës me gojë;
 - deklarata e regjistrimit audio;
 - deklarata e paanësisë së KPND;
 - raporti i KPND;
 - vendimi për rezultatin përfundimtar të kandidatit fitues;
 - shpallja e fituesit në AKPA;
 - akti që materializon vendimin për pranimin në shërbimin civil sipas nenit 26/4 (për 20%) dhe për pranim në shërbimin civil, në nivelin e lartë drejtues (për 15 %);
 - verifikimi paraprak/verifikimi përfundimtar pas ankimimit (nëse ka dhe dërgimi për publikim);
 - procesverbali i prezencës në testimin me shkrim;
 - hartimi i tezës nga KPND /sekretimi;
 - verifikimi i përgjigjeve të dhëna nga kandidatët e kualifikuar për testimin me shkrim sipas pyetjeve të përzgjedhura nga KPP për këtë fazë;
 - procesverbali i prezencës në intervistën me gojë;
 - pyetjet e intervistës me gojë;
 - deklarata e regjistrimit audio;
 - deklarata e paanësisë së KPND;
 - raporti i KPND;
 - vendimi për rezultatin përfundimtar të kandidatit fitues
 - shpallja e fituesit në AKPA;
 - akti i emërimit të punonjësve në pozicionin e shërbimit civil
 - etj.
6. Materialet që dokumentojnë zhvillimin e procedurës disiplinore.
- kërkesa për fillimin e ecurisë disiplinore;
 - ngritja e Komisionit të Disiplinës;
 - njoftimi me shkrim i nëpunësit për fillimin e ecurisë disiplinore;
 - shkakun e nisjes, si dhe të drejtat e nëpunësit për sqarimin e shkeljes;
 - vendimi i Komisionit të Disiplinës i arsyetuar në shpjegimin e fakteve.
7. Dosjet e personelit dhe regjistri i personelit.
8. Materiale të tjera të cilat janë konsideruar të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të mbikëqyrjes.

Metodologjia e mbikëqyrjes:

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin e gjithë dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivën e

institucionit, si dhe në sektorin e shërbimeve mbështetëse, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u ndërmorën veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim me Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse znj *Jetmira Leka* dhe Specialisten në Sektorin e Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse znj. *Sara Ndoci*, gjatë të cilit u diskutua mbi qëllimin, programin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej t'i vihej në dispozicion grupit të mbikëqyrjes për verifikim.
- U verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës, të miratuar për Bashkinë Lezhë.
- U verifikuan procedurat e pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë; dokumentet e administruara në dosjen e personelit që provojnë plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil sipas përcaktimeve të nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
- U verifikuan të dhënat individuale të çdo nëpunësi civil, lidhur me përmbushjen e kërkesave specifike të pozicionit të punës si, niveli i diplomës së studimeve universitare, fusha kryesore e studimeve dhe përvoja në punë e lidhur me e arsimin e lartë që ka çdo nëpunës civil.
- U verifikua ligjshmëria e akteve të deklarimit të statusit të nëpunësit civil, për të gjithë ata nëpunës që e kanë përfituar këtë status sipas parashikimeve të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Konstatimet janë të materializuara si tabela më vete të cilat janë pjesë e këtij raporti (*Aneksi 1; Aneksi 2*).

Përmbajtja e Raportit:

Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë aplikimit në praktikë të procesit të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

I. Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes.

Bashkia, si organ i vetëqeverisjes vendore, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999 “*Statusi i nëpunësit civil*” (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, pasi në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, organet e qeverisjes vendore janë riorganizuar në drejtim të burimeve njerëzore por edhe të kompetencave ligjore.

Konkretisht, në nenin 54 të ligjit, ku parashikohen detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, në shkronjën “dh” përcaktohet se, **këshilli bashkiak** miraton buxhetin dhe numrin maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë.

Ndërsa në nenin 64 të këtij akti ligjor, ku parashikohen detyrat dhe kompetencat e kryetarit të bashkisë, në shkronjën “j”, përcaktohet se, **kryetari i bashkisë**, miraton strukturën, organikën e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Aktualisht, në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, institucioni është i organizuar dhe funksionon mbi bazën e strukturës dhe organikës të miratuar me Urdhrin nr. 3, (nr.35 Prot.) datë 3.1.2024, e ndryshuar, të Kryetarit të Bashkisë Lezhë “Për miratimin e strukturës, organikës, emërtimet e pozicioneve, klasat për çdo pozicion pune për administratën e bashkisë, të njësive administrative, të institucioneve vartëse dhe punonjësve të njësive të shërbimeve për vitin 2024”, ku përfshihen: numri i përgjithshëm i punonjësve për administratën e Bashkisë Lezhë, Njësitë Administrative pjesë përbërëse të saj (Shëngjin, Shënkoll, Zejmen, Kolsh, Balldre, Blinisht, Dajç, Kallmet dhe Ungrej), si dhe institucionet në varësi të kësaj bashkie.

Sipas kësaj strukture, **administrata e bashkisë**, ka gjithsej **860** pozicione pune, nga të cilat **182** pozicione pune, janë **pjesë e shërbimit civil** dhe në të, janë të përfshira edhe funksionet e njësive administrative që janë në varësi të kësaj bashkie.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, **pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil** në administratën e Bashkisë Lezhë, paraqiten në këtë raport:

- **Nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese** - **1 pozicion pune**, që i përket pozicionit të punës “Sekretar i Përgjithshëm”;
- **Nëpunës civilë të kategorisë së mesme drejtuese** - **13 pozicione pune**, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”;
- **Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese** – **28 pozicione pune**, të cilat i përkasin pozicionit “Përgjegjës Sektori”;
- **Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive** - **140 pozicione pune**, të cilat i përkasin pozicionit “Specialist”.

Në mënyrë të detajuar, kjo gjendje është pasqyruar në **Tabelën nr. 1** - “Nëpunës të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, në Bashkinë Lezhë”, e cila është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Konstatim:

Në këtë rubrikë të raportit duhet të diskutojmë në lidhje me procesin e vlerësimit të strukturës së institucionit në raport me kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.

Komisioneri ka nxjerrë urdhëzuesin nr.1082 prot., datë 14.12.2021 *“Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (bashki) për vitin 2022”*, në të cilin parashikohen standardet e ndërtimit të skemës së administrimit të shërbimit civil.

Më tej, ka dalë akti administrativ nr. 654, datë 02.10.2024, i Komisionerit, *“Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në strukturën organizative të institucioneve të administratës vendore dhe transferimin e nëpunësve civilë për shkak të ristrukturimit të institucionit”*, nëpërmjet të cilit kokretizohet zgjidhja e problemeve të evidentuara më parë dhe lihen detyra konkrete për aktorët që hartojnë dhe miratojnë strukturën e institucionit.


Në vijim të monitorimit të zbatimit të këtyre akteve, përgjatë vitit 2024, Komisioneri ka nisur procesin e mbikëqyrjes së orientuar, për të cilën janë informuar të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke kërkuar bashkëpunimin e tyre.

Në rastin e Bashkisë Lezhë, rezulton se janë bërë përpjekje nga njësia përgjegjëse e institucionit, duke vlerësuar orientimet e Komisionerit dhënë në udhëzimet e tij, si edhe në emailin e datës 15.02.2024, të pasqyruara në strukturën e aktuale, kjo për sa i përket standarteve numerike, por e rëndësishme është që të rivlerësohen detyrat që kryejnë dhe raporti që kanë me shërbimin civil, për disa pozicione “specialist/koordinator”, pasi janë pozicioneve me kod pune, por që për shkak të emërtesës dhe kategorisë së pagës, i evidentojmë si pozicione të shërbimit civil *(nëse është për shkak vetëm të kategorizimit të pagave atëherë edhe kjo të sqarohet, shoqëruar me aktin përkatës)*.

Gjithashtu konstatohet se, vijon të jetë evidente prania e pozicioneve të punës “specialist” në njësitë administrative të institucionit, ndërkohë që Komisioneri është i mendimit se këto pozicione kanë nevojë ti nënshtrohen një procesi më të gjerë vlerësimi, nëse kryejnë ose jo detyra të nëpunësit civil, ashtu si dhe do sqarojmë në vijim.

Në vijim për të saktësuar çfarë analizua më sipër, po paraqesim një model të paraqitjes së strukturës organizative të institucionit, dhe organikës (organigramës).

1. Modeli i strukturës së institucionit:



2. Modeli i organikës (organogramës) së institucionit:

ORGANIKA E BASHKISË, INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË SAJ

DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE

	POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I.	Kryetari i BASHKISË		1
II.	Kabineti i kryetarit		(Numri i përgjithshëm i pozicioneve të funksionarëve politikë)
	Zv/ kryetar		1
	Nënkryetar		1
	E vijon..		1
			2
III.	Sekretar i Përgjithshëm	I-b	1
IV.	Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit		(Numri i përgjithshëm i pozicioneve të njësive drejtori)

Drejtor

II-b

1

**Sektori i Planifikimit, Koordinimit,
Projekteve Strategjike të Territorit dhe
Infrastrukturës Publike**

(Numri i
përgjithshëm i
pozicioneve të
njësisë sektor)

Përgjegjës Sektori

III-a/1 ose III-b

Specialist

IV-a ose IV-b

Specialist

IV-a ose IV-b

E vijon.....

Pasi të përfundojnë këto procese të evidentuara më sipër, atëherë hartohet **struktura analitike e institucionit**, në të cilën identifikohen nëpunësit civilë sipas gjeneraliteteve të tyre, pozicioni ku ata kryejnë detyrën si edhe paga përkatëse dhe që shërben më tej për të përgatitur listëprezencën dhe listëpagesën e institucionit.

Me qëllim që të rregullohet skema e administrimit të shërbimit civil në strukturën e miratuar me Vendimin nr. 695 (20388 prot.), datë 30.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë Lezhë, “*Për disa ndryshime në urdhërin nr.3, datë 03.01.2024 “ Për miratimin e strukturës, organikës, emërtimet e pozicioneve, klasat për çdo pozicion pune për administratën e bashkisë, të njësive administrative, të institucioneve vartëse dhe punonjësve të njësive të shërbimeve për vitin 2024” i ndryshuar*”, e cila u administrua gjatë procesit të mbikëqyrjes, dhe që të përcaktohen qartë pozicionet që rregullohen nga ligji për nëpunësin civil, Komisioneri çmon se procesi duhet të vijojë në drejtim të rivlerësimit të pozicioneve të punës në raport me shërbimin civil, në këto drejtime:

- Fillimisht, institucioni (*Njësia përgjegjëse*) duhet të përcaktojë nëpunësin civil/grupin e punës, i cili është përgjegjës për mbledhjen e informacionit për pozicionet e punës dhe analizimin e këtij informacioni, me qëllim përcaktimin e saktë të detyrave, përgjegjësi e kërkesave të veçanta në hartimin e përshkrimeve të punës.
- Njësia përgjegjëse duhet të kryejë analizën e tipareve të funksioneve të pozicioneve të punës duke përcaktuar qartë nivelet: a) pozicionet politike, b) nëpunësit civilë dhe c) punonjësit administrativë në mënyrë që të bëjë shpërndarjen e punonjësve sipas këtyre niveleve. Me qëllim përcaktimin e vlerës relative të çdo pozicioni pune të shërbimit civil duhet të kryhet klasifikimi i çdo pozicioni aktual të përfshirë në strukturën e institucionit, për pjesën e shërbimit civil, për të mundësuar klasifikimin e tyre sipas kategorisë, klasës përkatëse dhe natyrës së pozicionit, duke u bazuar në përshkrimin e punës të çdo pozicioni, siç përcaktohet në kreun III, “*Klasifikimi i pozicioneve në shërbimin civil*”, neni 19, i ligjit nr. 152/2023, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

- Për të mundësuar realizimin e këtij procesi, Njësia përgjegjëse duhet të nisë procesin e vlerësimit të pozicioneve të punës, në raport me shërbimin civil bazuar në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar. Ky vlerësim duhet të bazohet në analizën e punës si dhe në përshkrimet e punës për çdo pozicion i cili është pjesë e shërbimit civil, duke vepruar me këtë rend pune:
 - a) Së pari, duhet të ngrihet Komiteti i Vlerësimit, i cili në rastin e institucioneve të vetëqeverisjes vendore, krijohet nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit ose pozicioni i barasvlershëm me të, i cili do të përbëhet nga tre anëtarë: njëri nga anëtarët është i ngarkuari me detyrën e analistit të punës, ose ndonjë funksion tjetër të menaxhimit të burimeve njerëzore, kurse dy anëtarët e tjerë janë nëpunës civilë me përvojë në institucion.
 - b) Pas kësaj, Komiteti i Vlerësimit duhet të bëjë identifikimin e pozicionit/pozicioneve të punës që do të vlerësohen/rivlerësohen. Më tej, procesi do të vijojë me vlerësimin dhe klasifikimin e tyre duke u mbështetur në përshkrimet e punës të cilët administrohen nga njësia e burimeve njerëzore dhe në metodologjinë e përcaktuar në lidhjen nr. 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.

Ndërkohë, sa i takon klasave dhe kategorive të zbatueshme për pozicionet e punës për nëpunësit civilë, njësia përgjegjëse duhet të bazohet në përcaktimet e Vendimit nr. 503 datë 01.08.2004 të Këshillit të Ministrave, *“Për disa ndryshime në endimin nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”*, ku përcaktohen nivelet e pagave për nëpunësit civilë të njësive të vetëqeverisjes vendore sipas nivelit të nëpunësisë civile, të grupuara në bazë të numrit të banorëve.

Më pas, në përfundim të këtyre procedurave duhet të kalohet në kryerjen e procedurave të tjera administrative të parashikuara nga legjislacioni i shërbimit civil, ku përgjegjëse për kryerjen e tyre është Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit (*Njësia përgjegjëse*).

Ndërkohë, konstatohet se nga ana e institucionit **është vepruar** në drejtim të ngritjes së organeve të rivlerësimit dhe njoftimit të subjekteve të ngarkuara prej ligjit me hartimin dhe rishikimin e përshkrimeve të punës, pasi me aktin nr. 600 (18063/1 prot.) datë 07.11.2024, është ngritur Komiteti i rivlerësimit dhe me aktin nr. 17930 prot., datë 06.11.2024, janë njoftuar subjektet përkatëse. Por, nga ana tjetër, rezulton që ky proces **ende nuk është finalizuar me aktet përkatëse**.

Institucioni i mbikëqyrur të analizojë dhe të konkludojë lidhur me arsyet e mosveprimit në kohë për të plotësuar këto detyrime dhe të informojë Komisionerin mbi masat e marra.

I/1 Mënyra e plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil në momentin e mbikëqyrjes në Bashkinë Lezhë.

Bazuar në strukturën dhe organikën që është në fuqi në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, Bashkia Lezhë ka **182** pozicione të shërbimit civil, nga të cilat **9** pozicione pune janë të lira, të organizuara në këtë mënyrë:

- ✓ **1 pozicion i kategorisë së lartë drejtuese** (pozicioni *Sekretar i Përgjithshëm*), është plotësuar me ngritje në detyrë, para periudhës objekt mbikëqyrjeje;
- ✓ **7 pozicione të cilat i përkasin kategorisë së mesme drejtuese**, janë plotësuar përmes procedurave të konkurrimit nga të cilat **2** me ngritje në detyrë dhe **5** me kandidatë nga jashtë shërbimit civil;
- ✓ **14 pozicione të cilat i përkasin kategorisë së nivelit të ulët drejtuese**, janë plotësuar përmes procedurave të konkurrimit për **11** pozicione (**5** me ngritje në detyrë dhe **6** me kandidatë nga jashtë shërbimit civil) dhe **3** me punonjës ekzistues;
- ✓ **99 pozicione të cilat i përkasin kategorisë ekzekutive**, janë plotësuar nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil dhe lëvizjes paralele, dhe **18** me punonjës ekzistues;
- ✓ **5 pozicione të kategorisë së nivelit të mesëm drejtues** janë të zëna me emërimë në kundërshtim me ligjin;
- ✓ **12 pozicione të kategorisë së nivelit të ulët drejtues** janë të zëna me emërimë në kundërshtim me ligjin;
- ✓ **17 pozicione të kategorisë ekzekutive** janë të zëna me emërimë në kundërshtim me ligjin;
- ✓ **9 pozicione janë vakante**, nga të cilat **1** pozicion i përket kategorisë së nivelit të mesëm drejtuese, **2** pozicione kategorisë së nivelit të ulët drejtues dhe **6** pozicione kategorisë ekzekutive.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, në vijim, në përmbajtjen e këtij raporti do të analizohen në mënyrë të detajuar procedurat për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil.

II. Plan i vjetor i pranimit në shërbimin civil

Administrimi i shërbimit civil për të gjithë institucionet e administratës shtetërore bazohet në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, në të cilin janë përcaktuar procedurat e hollësishme për përgatitjen, miratimin, afatin e miratimit dhe mënyrën e bërjes publike të planit vjetor të punësimit.

Përgatitja e tij në mënyrë të detajuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore, përbën një garanci për zhvillimin e gjithë procedurave të konkurrimit.

Duke vazhduar më tej, në zbatim të detyrimeve të nenit 18, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku përcaktohet se; “.....dhe çdo institucion i pavarur, jo më vonë se muaji shkurt, miratojnë planin e veta të pranimeve vjetore.....”, institucioni duhet të miratojë planin vjetor të pranimi për pozicionet e lira pjesë e shërbimit civil, në bazë të të cilave administrohet i gjithë procesi i rekrutimit.

Këto dispozita përcaktojnë se, institucionet e pavarura, në përgatitjen e planit vjetor të pranimi në shërbimin civil, duhet të kenë parasysh nëpunësit që mbushin moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, krijimin e vendeve të reja të punës pjesë e shërbimit civil për shkak të ndryshimit të strukturës, si dhe krijimin e vendeve të lira për arsye të tjera, të cilat publikohen në portalin: “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, në faqen zyrtare të internetit dhe në standat për njoftime publike të institucionit.

➤ Plani i Pranimi në Shërbimin Civil, viti 2024

Për vitin 2024, me aktin nr. 49 (571 prot.), datë 16.01.2024 “Për miratimin e planit vjetor të pranimi në shërbimin civil për vitin 2024”, i ndryshuar, institucioni ka miratuar planin vjetor, në bazë të të cilit janë parashikuar për t’u zhvilluar procedurat e konkurrimit për **62** pozicione të lira në total, të ndara sipas kategorive:

- **9** pozicione pune të nivelit të mesëm drejtues;
- **15** pozicione pune të nivelit të ulët drejtues;
- **38** pozicione pune të nivelit ekzekutiv.

Konkretisht bëhet fjalë për **62** pozicionet e lira, të evidentuara si më poshtë:

1. Pozicioni “Drejtor”, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, kategoria II-2;
2. Pozicioni “Drejtor”, në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social, kategoria II-2;
3. Pozicioni “Drejtor”, në Drejtorinë e Emergjencave Civile, kategoria II-2;
4. Pozicioni “Drejtor”, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, kategoria II-2;
5. Pozicioni “Drejtor”, në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, kategoria II-2;
6. Pozicioni “Drejtor”, në Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës, kategoria II-2;
7. Pozicioni “Drejtor”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria II-2;
8. Pozicioni “Drejtor”, në Drejtorinë Juridike, kategoria II-2;
9. Pozicioni “Drejtor”, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, kategoria II-2;
10. Pozicioni “Përgjegjës”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, kategoria III-2;

11. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Mbledhjes dhe Menaxhimit të Borxhit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-2;
12. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Verifikimit dhe Kontrollit në Terren të Tatimpaguesve, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-2;
13. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Dhënies dhe Monitorimit të Lejeve Zhvillimore, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, kategoria III-2;
14. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Funksioneve Mbështetëse, në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, kategoria III-3;
15. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Pronave, në Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës, kategoria III-2;
16. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Kadastrës dhe Regjistrimit të Aseteve, në Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës, kategoria III-2;
17. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Legalizimit të Ndërtimeve pa Leje, në Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës, kategoria III-2;
18. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Emergjencave Civile, në Drejtorinë e Emergjencave Civile, kategoria III-3;
19. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Programeve të Zhvillimit, Transparencës, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, kategoria III-3;
20. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria III-2;
21. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Arsimit Parauniversitar, Rinisë dhe Sporteve, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, kategoria III-3;
22. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Arsimit Parashkollor, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, kategoria III-3;
23. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Promovimit të Turizmit dhe Kulturës, në Drejtorinë Turizmit dhe Kulturës, kategoria III-3;
24. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Ndjekjes dhe Zbatimit të Kontratave, në Drejtorinë Juridike, kategoria III-2;
25. Pozicioni “*Specialist për Monitorimin e Projekteve*”, në Sektorin e Hartimit të Projekteve, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, kategoria IV-2;
26. Pozicioni “*Specialist për Hartimin e Projekteve*”, në Sektorin e Hartimit të Projekteve, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, kategoria IV-2;
27. Pozicioni “*Specialist*”, në Sektorin e Dhënies dhe Monitorimit të Lejeve Zhvillimore, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, kategoria IV-2;
28. **Dy** pozicione “*Specialist Jurist*”, në Sektorin e Përputhshmërisë Ligjore dhe Përfaqësimit, në Drejtorinë Juridike, kategoria IV-2;
29. Pozicioni “*Specialist për Koordinimin me Sektorët/Njësitë/Financën dhe Protokollin*”, në Sektorin e Regjistrimit dhe Vlerësimit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria IV-2;

30. **Dy** pozicione “*Specialist për Vlerësimin dhe Regjistrimin për Njësitë Administrative*”, në Sektorin e Regjistrimit dhe Vlerësimit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria IV-2;
31. **Dy** pozicione “*Specialist i Mbledhjes së Borxhit*”, në Sektorin e Mbledhjes dhe Menaxhimit të Borxhit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria IV-2;
32. Pozicioni “*Specialist për Hartimin dhe Ndjekjen e Borxhit*”, në Sektorin e Hartimit, Zbatimit të Buxhetit dhe Pagave, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, kategoria IV-3;
33. Pozicioni “*Specialist Jurist*”, në Sektorin e Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria IV-2;
34. **Dy** pozicione “*Specialist Protokoll*”, në Sektorin e Protokoll-Arkivës, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria IV-2;
35. Pozicioni “*Specialist Inxhinier Gjeode*”, në Sektorin e Funksioneve Mbështetëse, në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, kategoria IV-3;
36. Pozicioni “*Specialist Inxhinier*”, në Sektorin e Funksioneve Mbështetëse, në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, kategoria IV-2;
37. Pozicioni “*Specialist Veterinar*”, në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Kontrollit Veterinar, në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, kategoria IV-2;
38. Pozicioni “*Specialist IT*”, në Sektorin e Programim Zhvillimit, Komunikimit dhe Transparencës, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, kategoria III-3;
39. Pozicioni “*Specialist Psikolog*”, në Sektorin e Arsimit Parashkollor, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, kategoria III-3;
40. Pozicioni “*Specialist Jurist*”, në Sektorin e Infrastrukturës, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, kategoria IV-2;
41. Pozicioni “*Specialist Ndërtimi/Inxhinier Gjeode*”, në Sektorin e Infrastrukturës, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, kategoria IV-2;
42. Pozicioni “*Specialist Supërvizor për Dekorin/Gjelbërimin, Varrezat dhe Punët Publike*”, në Sektorin e Mbikëqyrjes së Shërbimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, kategoria IV-2;
43. Pozicioni “*Specialist*”, në Sektorin e Dhënies dhe Monitorimit të Lejeve Zhvillimore, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, kategoria IV-2;
44. Pozicioni “*Specialist*”, në Sektorin e Integritimit Evropian dhe Ndihmës së Huaj, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, kategoria IV-3;
45. **Dy** pozicione “*Specialist*”, në Sektorin e Emergjencave Civile, në Drejtorinë e Emergjencave Civile, kategoria IV-3;
46. Pozicioni “*Specialist i Bujqësisë Pyjeve dhe Ujitjes*”, në Njësinë Administrative Blinisht, kategoria IV-4;
47. **Dy** pozicione “*Specialist i Mbrojtjes së Fëmijëve*”, në Sektorin e Kujdesit Social dhe Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social, kategoria IV-2;

48. Pozicioni “*Specialist për Vlerësimin dhe Regjistrimin*”, në Sektorin e Regjistrimit dhe Vlerësimit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria IV-2;
49. **Dy** pozicione “*Specialist*”, në Sektorin e Legalizimit të Ndërtimeve pa Leje, në Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës, kategoria IV-2;
50. Pozicioni “*Specialist Kontabilitetit*”, në Sektorin e Kontabilitetit, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, kategoria IV-2;
51. Pozicioni “*Specialist i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren*”, në Sektorin e Verifikimit dhe Kontrollit në Terren të Tatimpaguesve, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria IV-2;
52. Pozicioni “*Specialist i Ndhmës Ekonomike*”, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe PAK, në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social, kategoria IV-2;
53. Pozicioni “*Specialist Finance*”, në Sektorin e Arsimit Parauniversitar, Rinisë dhe Sporteve, në Drejtorinë e Sektorin e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, kategoria IV-3;
54. Pozicioni “*Specialist Jurist*”, në Sektorin e Ndjekjes dhe Zbatimit të Kontratave, në Drejtorinë Juridike, kategoria IV-2;
55. Pozicioni “*Specialist Inxhinier*”, në Sektorin e Ndjekjes dhe Zbatimit të Kontratave, në Drejtorinë Juridike, kategoria IV-2.

Referuar të dhënave të administruara nga dosjet e konkurrimit, deri në momentin e realizimit të mbikëqyrjes në institucion rezulton se janë plotësuar me procedura konkurrimi vetëm **32** pozicione të planifikuara. Bëhet fjalë për këto pozicione:

1. Pozicioni “*Specialist Inxhinier*”, në Sektorin e Funksioneve Mbështetëse, në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, kategoria IV-a;
2. Pozicioni “*Specialist për Hartimin e Projekteve*”, në Sektorin e Hartimit të Projekteve, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, kategoria III-b;
3. Pozicioni “*Specialist*”, në Sektorin e Dhënies dhe Monitorimit të Lejeve Zhvillimore, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, kategoria III-b;
4. **Dy** pozicione “*Specialist i Mbledhjes së Borxhit*”, në Sektorin e Mbledhjes dhe Menaxhimit të Borxhit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-b;
5. Pozicioni “*Specialist për Vlerësimin dhe Regjistrimin*”, në Sektorin e Regjistrimit dhe Vlerësimit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-b;
6. Pozicioni “*Specialist Protokoll*”, në Sektorin e Protokoll-Arkivës, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria IV-2;
7. Pozicioni “*Specialist Arkitekt*”, në Sektorin e Programim Zhvillimit, Komunikimit dhe Transparencës, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, kategoria IV-a;
8. Pozicioni “*Specialist i Bujqësisë Pyjeve dhe Ujitjes*”, në Njësinë Administrative Blinisht, kategoria IV-b;
9. **Dy** pozicione “*Specialist Protokoll*”, në Sektorin e Protokoll-Arkivës, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria III-b;
10. Pozicioni “*Specialist për Hartimin dhe Ndjekjen e Borxhit*”, në Sektorin e Hartimit, Zbatimit të Buxhetit dhe Pagave, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, kategoria IV-a;

11. Pozicioni “*Specialist Finance*”, në Sektorin e Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria III-b;
12. **Dy** pozicione “*Specialist Jurist*”, në Sektorin e Përputhshmërisë Ligjore dhe Përfaqësimit, në Drejtorinë Juridike, kategoria III-b;
13. Pozicioni “*Specialist Jurist*”, në Sektorin e Infrastrukturës, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, kategoria IV-2;
14. **Dy** pozicione “*Specialist*”, në Sektorin e Legalizimit të Ndërtimeve pa Leje, në Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës, kategoria IV-2;
15. Pozicioni “*Specialist për Koordinimin me Sektorët/Njësitë/Financën dhe Protokollin*”, në Sektorin e Regjistrimit dhe Vlerësimit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-b;
16. Pozicioni “*Specialist për Vlerësimin dhe Regjistrimin për Njësitë Administrative*”, në Sektorin e Regjistrimit dhe Vlerësimit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-b;
17. Pozicioni “*Specialist Inxhinier Gjeodet*”, në Sektorin e Funksioneve Mbështetëse, në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, kategoria IV-a;
18. Pozicioni “*Specialist Veterinar*”, në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Kontrollit Veterinar, në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, kategoria IV-a;
19. Pozicioni “*Specialist*”, në Sektorin e Integritit Evropian dhe Ndihmës së Huaj, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, kategoria IV-a;
20. Pozicioni “*Specialist*”, në Sektorin e Dhënies dhe Monitorimit të Lejeve Zhvillimore, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, kategoria III-b;
21. Pozicioni “*Specialist për Hartimin e Projekteve*”, në Sektorin e Hartimit të Projekteve, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, kategoria III-b;
22. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Funksioneve Mbështetëse, në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, kategoria III-a/1;
23. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Verifikimit dhe Kontrollit në Terren të Tatimpaguesve, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-2;
24. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Verifikimit dhe Kontrollit në Terren të Tatimpaguesve, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-a;
25. Pozicioni “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Mbledhjes dhe Menaxhimit të Borxhit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-a;
26. Pozicioni “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria II-b;
27. Pozicioni “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social, kategoria II-b;
28. Pozicioni “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, kategoria II-2.

Referuar pozicioneve vakante të evidentuara në planet e pranimit për vitin 2024, të planifikuara për t’u plotësuar përmes procedurave të konkurrimit konstatohet se, në institucionin e mbikëqyrur janë zhvilluar gjithsej 23 procedura konkurrimi (3 nga të cilat nuk janë planifikuar në planin e pranimit), për plotësimin e 32 pozicioneve të lira, të ndara në këto kategori të nëpunësisë civile

(25 emërimë në kategorinë ekzekutive, 4 emërimë në kategorinë e ulët drejtuese dhe 3 emërimë në kategorinë e mesme drejtuese).

Konstatohet se për periudhën objekt mbikëqyrje **4** pozicione pune janë plotësuar me kandidatë me pranim nga jashtë shërbimit civil, nga të cilat **2** pozicione i përkasin kategorisë së nivelit të ulët drejtues dhe **2** pozicione kategorisë së nivelit të mesëm drejtues, sipas parashikimit në urdhrin nr. 63 (803 prot.), datë 21.01.2024, “Për miratimin e pozicioneve të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese të cilat do të jenë të hapura për konkurrim dhe për pranim nga jashtë shërbimit civil”, të titullarit të institucionit.

Në bazë të përcaktimeve të pikës 13, të VKM nr. 108, datë 26.2.2014, në të gjitha rastet, vendimi për miratimin e planit vjetor të punësimit, është publikuar në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, si dhe në faqen e internetit të institucionit.

Konstatim: Nga ana e institucionit të mbikëqyrur plani vjetor i pranimit në shërbimin civil është hartuar dhe miratuar brenda afatit të përcaktuar, duke marrë në konsideratë të gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në parashikimet e nenit 18, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

Gjithashtu, në varësi të dinamikave të ndryshimeve të marrëdhënies së punësimit, njësia përgjegjëse, ka ndryshuar disa herë brenda vitit planin e pranimit, duke përfshirë në këtë akt, pozicionet e reja vakante të krijuara në institucion.

Konstatohet se, njësia përgjegjëse ka grupuar sipas kategorisë dhe kriterëve të pozicioneve të punës vendet vakante, të planifikuara për tu plotësuar përmes procedurave të konkurrimit, **duke i kryer në grup pozicionesh** këto procedura konkurrimi.

Përsa i përket realizimit të planit të pranimit, konstatohet se nuk janë zhvilluar të gjitha procedurat e rekrutimit sipas planit të miratuar, për shkak të numrit të lartë të pozicioneve vakante dhe mungesës së kohës për ti zhvilluar procedurat e konkurrimit. Ndërkohë që, rezulton se, **32** pozicione të planifikuara në planin e pranimit janë të plotësuara në kundërshtim me ligjin, me akte të përkohshme emërimi duke mos zhvilluar procedurat e konkurrimit dhe **9** pozicione rezultojnë të jenë të lira.

III. Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, nivelin e ulët, të mesëm drejtues dhe nivelit të lartë drejtues nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 22, 25, 26 dhe 32, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore që rregullojnë këto institute të ligjit.

Bazuar në kreun IV, V dhe VI, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pozicionet e lira pjesë e shërbimit civil, plotësohen vetëm nëpërmjet procedurave të konkurrimit dhe njësi përgjegjëse për realizimin e procedurave të konkurrimit, është njësia e burimeve njerëzore të institucionit.

Për sa më sipër, Komisioneri verifikoi emërimet në pozicionet e shërbimit civil nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë të kryera në momentin e mbikëqyrjes.

III/1 Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv nëpërmjet konkurrimit.

Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil nëpërmjet konkurrimit të hapur, rregullohet nga ligji nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar (kreu IV *“Pranimi në shërbimin civil”*, nenet 20, 21, 22, 23 e 25); Vendimi nr. 243, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr. 2, datë 27.3.2015, i Departamentit të Administratës Publike *“Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”* (kreu III *“Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive”*).

Këto dispozita ligjore përcaktojnë rregullat procedurale të konkurrimit, për plotësimin e pozicioneve të punës në nivelin ekzekutiv, sipas të cilave, fillimisht organizohet procedura e lëvizjes paralele e më pas, nëse mbeten pozicione të lira, pas aplikimit të procedurës së lëvizjes paralele, njësia përgjegjëse, i plotëson ato me anën e procedurës për pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

Në pikën 2, të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe në pikën 2, të kreut II, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015 *“Për pranimin lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, është përcaktuar se, konkurrimi organizohet në mënyrë periodike nga njësia përgjegjëse, si për grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe për grupin e pozicioneve të administrimit të posaçëm. Njësitë përgjegjëse në institucionet e vetëqeverisjes vendore organizojnë procedurën për institucionet respektive.

III/1/a. Procedura e lëvizjes paralele në kategorinë ekzekutive.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të kategorisë ekzekutive, rezulton se, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele është plotësuar pozicioni *“Specialist për Hartimin e Projekteve”*, në Sektorin e Hartimit të Projekteve, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, kategoria III-b;

Në këtë procedurë ka patur **1** kandidat, i cili gëzonte statusin si nëpunës civil brenda të njëjtës kategori (kandidati kryente detyra brenda institucionit), plotësonte kushtet e përgjithshme për lëvizjen paralele, si dhe kërkesat e posaçme të vendit të punës, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 25, të ligjit.

Pozicioni **është shpallur** në datën 05.03.2024, në portalin Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe në faqen e internetit të institucionit të Bashkisë Lezhë.

Në përmbajtjen e shpalljes për konkurrim, **janë të përfshira** të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 4, të kreut VII, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, siç janë:

- a) pozicioni i punës që është vakant (*emërtesa e pozicionit sipas strukturës dhe organikës në fuqi*);
- b) përshkrimi i përgjithshëm i punës për atë pozicion;
- c) kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët;
- ç) dokumentet që duhet të dorëzohen nga kandidatët dhe mënyra e dorëzimit të tyre;
- d) afati i dorëzimit që është i përcaktuar me datë të saktë kalendarike;
- dh) data e daljes së rezultateve për fazën e verifikimit paraprak të kushteve minimale të procedurës së lëvizjes paralele dhe të përmbushjes së kriterëve specifike të vendit të punës;
- e) fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë;
- f) mënyra e vlerësimit të kandidatëve;
- g) data e daljes së rezultateve të konkurrit;
- gj) mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Procedura e lëvizjes paralele, sipas pikës 6, kreu VII, të VKM nr.243, datë 18.3.2015, përfshin dy faza:

- a) Verifikimin e kandidatëve, të cilët përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.
- b) Vlerësimin e kandidatëve, ku përfshihen vlerësimi i përvojës në punë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet pozitive dhe intervista e strukturuar me gojë.

Nga këqyrja e materialeve rezulton se, në zbatim të pikave 7, 8, 9 e 10, të kreut VII, të këtij akti nënligjor, njësia përgjegjëse ka vepruar si më poshtë:

- **Ka kryer** verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
- **Ka realizuar** njoftimin e verifikimit paraprak (*lista me emrat e kandidatëve*), publikuar në AKPA dhe në faqen e internetit të institucionit;
- Në fazën e verifikimit paraprak nuk ka patur kandidatë të s'kualifikuar.

➤ *Vlerësimi i kandidatëve nga Komisioni i Brendshëm.*

Në bazë të përcaktimeve të pikës 3, të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pikave 12 - 18/1, të kreut VII, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrit të hapur”, kandidatët e kualifikuar për të kaluar në

fazën e dytë të konkurrimit, vlerësohen nga Komisioni i Brendshëm, i cili bazohet në strukturën e ndarjes së pikëve si më poshtë:

- a) 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë, për përvojën (*10 pikë për tejkalim të lehtë të kërkesave; 15 pikë për tejkalim të kërkesave; 20 pikë për tejkalim domethënës të kërkesave*), 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse (*3 pikë për tejkalim të lehtë të kërkesave; 5 pikë për tejkalim të kërkesave; 10 pikë për tejkalim domethënës të kërkesave*), 10 pikë për certifikimin/vlerësimet më të fundit pozitive (*5 pikë për certifikimin/vlerësimin “mirë”; 10 pikë për certifikimin/vlerësimin në nivelin “shumë mirë”*).
- b) 60 pikë intervista me gojë.

Komisioni i Brendshëm, sipas përcaktimit të pikës 12, kreut VII, i VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, ka në përbërje të tij 3 anëtarë:

- a) 1 përfaqësues nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, kur është e mundur, i të njëjtit nivel ose i një niveli më të lartë se pozicioni që rekrutohet;
- b) eprorin direkt;
- c) 1 përfaqësues të emëruar nga titullari i institucionit.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, përbërja e Komisionit të Brendshëm të ngritur me Urdhrin nr.180 (3754 prot.), datë 26.03.2024, të kryetarit, për këtë procedurë konkurrimi, **është në përputhje** me kërkesat e këtij akti nënligjor.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, Komisioni i Brendshëm ka vepruar në këtë mënyrë, në lidhje me vlerësimin e kandidatit:

- ✓ Është njoftuar kandidati nëse është dakord që intervista të regjistrohet; në deklaratën e nënshkruara prej tij, kandidati pjesëmarrës nuk ka pranuar që intervista të regjistrohet.
- ✓ Në përfundim të procedurave të konkurrimit, Komisioni i Brendshëm ka kryer vlerësimin përfundimtar për dokumentacionin e dorëzuar dhe intervistën me gojë, duke vlerësuar kandidatin për secilën procedurë, përkatësisht: Kleivis Marku me 84 pikë.

Në përfundim të procedurës, **është publikuar** shpallja e fituesit, në portalin AKPA dhe në faqen zyrtare të bashkisë. Më pas, njësia përgjegjëse me aktin nr. 4235, datë 8.4.2024, **ka emëruar** në pozicionin *“Specialist për Hartimin e Projekteve”*, në Sektorin e Hartimit të Projekteve, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, kandidatin fitues Kleivis Marku.

Aktualisht, nëpunësi në fjalë me Vendimin nr.6631/1 prot., datë 16.05.2024, *“Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...”*, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, është liruar nga kjo detyrë, mbështetur në kërkesën e tij për dorëheqje, e protokolluar me nr. 6631 prot., datë 15.05.2024.

III/1/b. Procedura e pranimi në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive.

Nga analiza e të dhënave të mbledhura për periudhën objekt mbikëqyrjeje, rezulton se, nga 25 pozicione pune që i përkasin kategorisë ekzekutive, me emërtesën “*Specialist*”, të cilat janë plotësuar nëpërmjet konkurrimit të hapur, 1 pozicion pune është plotësuar nëpërmjet lëvizjes paralele, ndërsa 24 pozicione pune janë plotësuar nëpërmjet pranimi në shërbimin civil.

Komisioneri verifikoi hapat proceduralë që ka ndjekur institucioni i mbikëqyrur, për menaxhimin e procesit të konkurrimit lidhur me plotësimin e vendeve vakante të kategorisë ekzekutive, si dhe respektimi i afateve procedurale të përcaktuara nga ligji dhe aktet nënligjore.

Gjatë zhvillimit të këtyre procedurave, njësia përgjegjëse ka vepruar si më poshtë:

- Në shpalljen e vendit të lirë, **është përcaktuar se aplikohet në të njëjtën kohë për të dy procedurat (lëvizje paralele, pranimi në shërbimin civil), duke përcaktuar për secilën procedurë afatin e dorëzimit të dokumenteve me datë të saktë kalendarike.**

Në këtë rast njësia përgjegjëse **ka vepruar** në përputhje me rregullimet e pikës 1, të nenit 25, të ligjit për nëpunësin civil, ku parashikohet se plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, bëhet së pari nga nëpunës civilë të së njëjtës kategori nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe nëse në përfundim të kësaj procedure nuk ka një fitues, atëherë njësia përgjegjëse organizon procedurën e pranimi në shërbimin civil nëpërmjet konkurrimit të hapur.

- Shpalljet për vendet e lira të publikuara në portal dhe në faqen zyrtare të bashkisë, kanë të përfshirë në përmbajtjen e tyre të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën 9, të kreut II, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, si dhe kategorinë/klasën e pagës të pozicionit për të cilin është organizuar konkurrimi.
- Konkurrimi është shpallur sipas rastit vetëm për një pozicion pune të kategorisë ekzekutive ose për grup pozicionesh sipas ndarjes që ju bën ligji kësaj kategorie në grupe të administrimit të përgjithshëm dhe grupe të administrimit të posaçëm. Në zbatim të nenit 19, pika 8, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pozicionet e nivelit ekzekutiv klasifikohen sipas natyrës së pozicionit, konkretisht në grupet e administrimit të përgjithshëm dhe në grupet e administrimit të posaçëm. Më tej, në kreun II, pika 1, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, përcaktohet se, procedura e pranimi në shërbimin civil, organizohet në mënyrë të ndarë për grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe për çdo grup të pozicioneve të administrimit të posaçëm.

Në këtë rast vërehet se, nga ana e institucionit **janë zbatuar** kërkesat e pikës 9, duke bërë shpalljen e procedurës së konkurrimit për grup pozicionesh në 9 procedura, për të cilat lloji i diplomës që kërkohet dhe kërkesat e posaçme të pozicionit të punës janë të njëjta, ndërsa në 7 procedura konkurrimi në shpallje është planifikuar vetëm një pozicion pune.

- Në këtë proces, u verifikua zbatimi i kërkesave të nenit 22, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore, si dhe afatet procedurale të parashikuara në pikën 8 e 10, të kreut II, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, ku përcaktohet se, shpallja e procedurës së pranimi bëhet të paktën 35 ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e konkurrimit; afati i dorëzimit të dokumentacionit për lëvizje paralele jo më pak se 10 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes; për pranim në shërbimin civil jo më pak se 15 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes.

Nga verifikimi rezultoi se, sipas përcaktimeve në pikën 2, të kreut IV, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, **brenda afatit** prej 16 ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimi të dokumentacionit për të gjitha procedurat e pranimi në shërbimin civil, njësia përgjegjëse **ka kryer** procesin e verifikimit paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

- Sa i takon menaxhimin të listës së pritjes, ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka përcaktuar se në rastet kur, për një konkurrim janë shpallur më shumë fitues se sa pozicionet vakante për të cilat është zhvilluar procedura e hapur e konkurrimit, njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 23, pika 3, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe pikës 18, të kreut IV, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i rendit kandidatët fitues, të cilët nuk janë emëruar për shkak të mungesës së vendeve vakante, në një listë me vlefshmëri 2- vjeçare. Nëse gjatë kësaj periudhe njësia përgjegjëse zhvillon një procedurë konkurrimi për të njëjtin grup pozicionesh, kandidatët fitues, të paemëruar ende, rirenditen në listën fituese të konkurrimit përkatës sipas rezultatit përfundimtar.

Pas verifikimit të listës së fituesve, e cila menaxhohet nga njësia përgjegjëse, rezultoi se, kandidatja **Natasha Cungu** është shpallur fituese në procedurën e konkurrimit të zhvilluar për plotësimin e pozicionit “*Specialist Protokoll*”, në Sektorin e Protokoll-Arkivës, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria IV-2, por nisur nga fakti se, për plotësimin e këtij pozicioni pune, në përfundim të procedurës së konkurrimit janë shpallur dy fitues, kandidati më pikët më të larta është emëruar në këtë pozicion pune, ndërsa kandidatja fituese **Natasha Cungu** është vendosur në listë pritje.

Konstatim: Gjatë verifikimit të dokumentacionit rezulton se në institucionin e mbikëqyrur **ka funksionuar** lista e pritjes pas konkurrimit.

Me vendimin nr. 19116/10, datë 7.1.2022, “Për rezultatin e procedurës së pranimi në kategorinë ekzekutive në shërbimin civil”, të Komitetit të Përschëm të Pranimi, kandidati **Bardhok Bruqa**, është shpallur fitues në procedurën e konkurrimit pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive, duke u vendosur në listë pritje.

Më tej, me aktin nr. 4844 prot., datë 07.04.2022, “Emërim i përkohshëm në detyrë”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, është emëruar përkohësisht në pozicionin

“*Specialist për Monitorimin e Projekteve*”, në Sektorin e Hartimit Projekteve, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, deri në përfundim të procedurave të konkurrimit.

Referuar dokumentacionit rezulton se, punonjësi Bardhok Bruga ka rezultuar fitues në një procedurë konkurrimi për pranimin në kategorinë ekzekutive, si rrjedhim, në mbështetje të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, ky kandidat fitues nga lista e pritjes, duhet të sistemohej në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, brenda kategorisë ekzekutive, në të cilin plotësonte kriteret e përgjithshme dhe të posaçme.

Në rastin konkret, njësia përgjegjëse, duhet të verifikonte pozicionet vakante në strukturë, për të evidentuar pozicionet në të cilat ky kandidat plotësonte kriteret, me qëllim emërimin e rregullt te tij në një pozicion të shërbimit civil.

Për më tepër, rezulton se, punonjësi Bardhok Bruga, plotëson kriterin arsimor për pozicionin e punës “*Specialist për Monitorimin e Projekteve*”, në Sektorin e Hartimit Projekteve, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, të cilin e kryen prej vitit 2022, si rrjedhim, akti i emërimit të përkohshëm i nxjerrë nga njësia përgjegjëse, për këtë punonjës **duhet të revokohet**, duke nxjerrë një akt të ri emërimi për punonjësin në fjalë, si “nëpunës civil në periudhë prove”, në pozicionin aktual.

➤ Krijimi i Komitetit të Përhershëm të Pranimi (KPP) dhe vlerësimi i kandidatëve

Nisur nga përcaktimi i pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe rregullave të përcaktuara në kreun III dhe IV (pikat nga 7 deri në 13), të VKM nr. 243, dt. 18.3.2015, i ndryshuar, kandidatët e kualifikuar për të kaluar në fazën e dytë të konkurrimit, vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimi (KPP).

Krijimi i KPP, përbërja e tij, si dhe detyrat që duhet të kryejë ky organ, janë të parashikuara në Kreun III dhe IV të VKM nr. 243, datë 18.3.2015 “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, si dhe ndarjen III/3, III/4, III/5, III/6, III/7 e III/8, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”.

Komiteti i Përhershëm i Pranimi, sipas pikës 3, kreu III, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, përbëhet nga pesë anëtarë:

- a) 1 anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson KPP-në;
- b) 2 anëtarë të zgjedhur nga titullari midis nëpunësve të institucionit, nëse është e mundur të nivelit të mesëm drejtues;
- c) 2 ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit për grupet përkatëse.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, rezulton që, institucioni i mbikëqyrur, me urdhër nr. 130, datë 26.02.2024, të Kryetarit, **është ngritur KPP**, me përbërje 5 anëtarë (3 përfaqësues të institucionit dhe 2 ekspertë të jashtëm). Gjatë vitit, me udhërin nr. 412, datë 23.08.2024, të kryetarit, ka ndryshuar një anëtar i KPP, konkretisht, anëtarja *Aurora Gjeloši*, me detyrë “Përgjegjës Sektori”, është zëvendësuar me anëtarin *Denis Përvathi*, me detyrë “Drejtor i Taksave”.

Konstatohet se, Komiteti i Përhershëm i Pranimit i ngritur si më sipër, **ka funksionuar** për të gjitha procedurat e konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të kategorisë ekzekutive, të shpallura përgjatë vitit, ashtu siç parashikon legjislacioni i shërbimit civil.

Mirëpo konstatohet, se në përbërje të KPP kanë qenë të njëjtët ekspertë të jashtëm, pavarësisht fushës së njohurive specifike që kërkontë pozicioni i punës i shpallur për tu plotësuar përmes procedurës së konkurrimit. Në lidhje me këtë konstatim, sjellim në vëmendje të njësisë përgjegjëse të institucionit që në vijim, duhet të tregojë kujdes në zgjedhjen e ekspertëve të jashtëm sipas fushës që do të kryhet testimi.

- Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se, për kryerjen e vlerësimit me shkrim të kandidatëve, anëtarët e KPP, kanë hartuar testet përkatëse, të cilat janë paraprirë nga vendimi për përzgjedhjen e pyetjeve, i mbajtur nga anëtarët e KPP. Në të gjitha rastet rezulton se **nuk është hartuar** çelësi i përgjigjeve që duhet ta administrojë secili prej anëtarëve të KPP në momentin e zhvillimit të konkurrimit.

Konstatohet se, testet përmbajnë pyetje me alternativa sipas rregullave të përcaktuara në pikën 2, të ndarjes III/5, të udhëzimit të DAP, brenda fushës së njohurive dhe aftësive mbi të cilat do të zhvillohet testimi, të përfshira në shpalljen për konkurrim, por **mungon** bashkëlidhur përgjigja e saktë për secilën pyetje.

- Sa i përket vlerësimit të konkurrentëve, anëtarët e KPP kanë korrigjuar testet dhe kanë vlerësuar kandidatët duke dhënë pikët për secilin. Në vlerësimin me shkrim, anëtarët e KPP, **kanë zbatuar** rregullat e pikës 8, të paragrafit III/6, të udhëzimit të DAP, duke pjestuar shumën totale të pikëve me pesë (në bazë të numrit të vlerësuesve).

Konkluzion: Nga verifikimet si më sipër, Komisioneri vlerëson se, nga njësia përgjegjëse janë bërë përpjekje që procedurat e rekrutimit nëpërmjet konkurrimit të hapur për kategorinë ekzekutive, të kryhen sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe kërkesat e VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, e ndryshuar.

Megjithatë, gjatë realizimit të procedurave të konkurrimit, në zbatim të realizimit të planit vjetor të rekrutimit për vitin 2024, evidentohen mangësi të karakterit material, të cilat nuk sjellin paligjshmëri të procedurës së konkurrimit, por që janë detyrim për tu plotësuar me qëllim garantimin e një procesi të drejtë, të paanshëm, e të bazuar në meritë. Bëhet fjalë për këto mangësi:

- Në të gjitha rastet mungon ***çelsi i përgjigjeve***, të cilën duhet ta duhet ta administrojë secili prej anëtarëve të KPP në momentin e zhvillimit të konkurrimit.
- Në të gjitha rastet mungon ***procesverbali i prezencës së intervistës së strukturuar me gojë***.

Në këto kushte, është detyrë e njësisë së burimeve njerëzore që të plotësojë proceset me këto akte dhe në të ardhmen të kujdeset për të respektuar të gjitha kërkesat për dokumentacionin që materializon procedurën e aplikuar në një rast konkurrimi dhe ti administrojë ato në dosjet përkatëse të secilës procedurë.

III/1/c. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u verifikua përmbushja e kërkesave ligjore të periudhës së provës, të përcaktuara nga neni 24, i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar; Kreu V, i Vendimit nr. 143, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, i shfuqizuar, (për të gjitha ato procedura që kanë filluar gjatë kohës që ka qenë në fuqi kjo VKM), si dhe Kreu VI, i Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.

Në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore, nëpunësi në periudhë prove është i detyruar të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA-s dhe udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.

Eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove, duhet të caktojë nëpunësin më të vjetër nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove, të bëjë vlerësimin e rezultateve individuale në punë për periudhën e provës dhe të nxjerrë vendimin për përfundimin e periudhës së provës.

Në zbatim të planit të mbikëqyrjes, Komisioneri verifikoi tërësinë e veprimeve të kryera për konfirmimin e nëpunësve civilë, të cilët i janë nënshtruar periudhës së provës dhe që aktualisht vazhdojnë marrëdhëniet e punësimit me institucionin.

- Në institucionin e mbikëqyrur për periudhën objekt kontrolli, siç edhe e kemi sqaruar më lart, në përfundim të procedurave të konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të kategorisë ekzekutive për vitin 2024, janë emëruar **24** punonjës, nga të cilët **1** punonjës ka dhënë dorëheqjen, në këto kushte, vetëm **23** punonjës janë *nëpunës civil në periudhë prove*. Bëhet fjalë për punonjësit e evidentuar më poshtë:

1. *Lauren Smaçi*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 11160 prot., datë 25.6.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist Inxhinier*”, në Sektorin e Funkcioneve Mbështetëse, në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, kategoria IV-a;

2. Silda Danaj, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 15393 prot., datë 20.09.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist për Hartimin e Projekteve*”, në Sektorin e Hartimit të Projekteve, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, kategoria III-b;
3. Silva Marku, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 15508 prot., datë 24.09.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist i Mbledhjes së Borxhit*”, në Sektorin e Mbledhjes dhe Menaxhimit të Borxhit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-b;
4. Aldo Gjini, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 15509, datë 24.09.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist i Mbledhjes së Borxhit*”, në Sektorin e Mbledhjes dhe Menaxhimit të Borxhit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-b;
5. Erjona Martini, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 15510 prot., datë 24.09.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist për Vlerësimin dhe Regjistrimin*”, në Sektorin e Regjistrimit dhe Vlerësimit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-b;
6. Marinela Zeka, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 360 datë 13.1.2025, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist Protokolli*”, në Sektorin e Protokoll-Arkivës, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria IV-2;
7. Doriana Sherri, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 16874 prot., datë 18.10.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist Arkitekt*”, në Sektorin e Protokoll Arkivit, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, kategoria IV-a;
8. Marjana Lazri, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 8014 prot., datë 28.05.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist i Bujqësisë Pyjeve dhe Ujitjes*”, në Njësinë Administrative Blinisht, kategoria IV-b;
9. Arjola Nikolli, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 11161 datë 24.06.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist Protokolli*”, në Sektorin e Protokoll-Arkivës, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria III-b;
10. Mirela Uka, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 11162. datë 24.6.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist Protokolli*”, në Sektorin e Protokoll-Arkivës, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria III-b;
11. Ersida Duka, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 10190 prot., datë 11.06.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist për Hartimin dhe Ndjekjen e Borxhit*”, në Sektorin e Hartimit, Zbatimit të Buxhetit dhe Pagave, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, kategoria IV-a;

12. Angjela Ujka, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 10189 prot., datë 11.06.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist Finance*”, në Sektorin e Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria III-b;
13. Blerina Zaja, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 13038 prot., datë 30.07.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Sektorin e Përputhshmërisë Ligjore dhe Përfaqësimit, në Drejtorinë Juridike, kategoria III-b;
14. Romina Malotaj, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 13033 prot., datë 30.07.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Sektorin e Përputhshmërisë Ligjore dhe Përfaqësimit, në Drejtorinë Juridike, kategoria III-b;
15. Klara Ndoka, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 4409 prot., datë 15.04.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Sektorin e Infrastrukturës, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, kategoria IV-2;
16. Dea Kraja, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 37, datë 6.1.2025, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Legalizimit të Ndërtimeve pa Leje, në Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës, kategoria IV-2;
17. Lindrit Preçi, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 35, datë 6.1.2025, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Legalizimit të Ndërtimeve pa Leje, në Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës, kategoria IV-2;
18. Sara Mehilli Kavaja, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 4700 prot., datë 22.04.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist për Koordinimin me Sektorët/Njësitë/Financën dhe Protokollin*”, në Sektorin e Regjistrimit dhe Vlerësimit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-b;
19. Klisman Dodaj, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 4701 prot., datë 22.04.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist për Vlerësimin dhe Regjistrimin për Njësitë Administrative*”, në Sektorin e Regjistrimit dhe Vlerësimit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-b;
20. Çesk Lleshi, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 3706 prot., datë 26.03.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist Inxhinier Gjeodet*”, në Sektorin e Funksioneve Mbështetëse, në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, kategoria IV-a;
21. Aldo Marku, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 4410 prot., datë 15.04.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist Veterinar*”, në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe

Kontrrollit Veterinar, në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, kategoria IV-a;

22. Kiara Alija, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 16056 prot., datë 04.10.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Integritimit Evropian dhe Ndihmës së Huaj, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, kategoria IV-a;
23. Behar Shpendi, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 6123 prot., datë 10.05.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Dhënies dhe Monitorimit të Lejeve Zhvillimore, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, kategoria III-b.

➤ Gjithashtu, nga këqyrja e dokumentacionit të administruar në dosjen personale të punonjësve, rezulton se, gjatë vitit 2024, ka përfunduar periudha e provës për **13** punonjës, procedura e konkurrimit për të cilët është kryer para periudhës objekt kontrolli. Nëpunësit që kanë përfunduar periudhën e provës evidentohen në vijim:

1. Merita Salihi, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 209 prot., datë 10.01.2023, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist Finance*”, në Sektorin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Pronave, në Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe Kadastres;
2. Bruno Sherri, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 2908 prot., datë 13.03.2023 dhe aktin nr.202 datë 08.01.2024 “*Transferim për shkak të ristrukturimit*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist i Mbledhjes dhe Përpunimit të Dhënave Statistikore dhe Monitorimin e Performancës*”, në Sektorin e Programim Zhvillimit, Komunikimit dhe Transparencës, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës;
3. Erestina Ndoka, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 17484 prot., datë 21.11.2023, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist i Promovimit të Turizmit*”, në Sektorin e Promovimit të Turizmit dhe Kulturës, në Drejtorinë e Turizmit dhe Kulturës;
4. Robert Prenga, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 2913 prot., datë 13.03.2023, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist i PAK dhe Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve*”, në Njësinë Administrative Shënkoll;
5. Stelina Shabi, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 2912 prot., datë 13.03.2023, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist i PAK dhe Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve*”, në Njësinë Administrative Balldren;
6. Fation Noka, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 566 prot., datë 17.01.2023 dhe aktin nr.183 datë 08.01.2024 “*Transferim për shkak të ristrukturimit*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist i*

- Kontrollit dhe Verifikimit në Terren*”, në Sektorin e Verifikimit dhe Kontrollit në Terren të Taksapaguesve, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore;
7. Ndue Gega, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 3211 prot., datë 21.03.2023, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist Inxhinier Gjeodet/Topograf*”, në Sektorin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Pronave, në Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës;
 8. Aurel Locaj, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 2909 prot., datë 13.03.2023, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist i Sporteve*”, në Sektorin e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe transferuar nëpërmjet aktit nr. 201 datë 08.01.2024 “*Transferim për shkak të ristrukturimit*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist i Sporteve*”, në Sektorin e Arsimit Parauniversitar, Rinisë dhe Sporteve, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve;
 9. Ornela Simoni, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 2910 prot., datë 13.03.2023, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist i Kujdesit të Fëmijëve me Nevoja Ndryshe*”, në Sektorin e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe transferuar nëpërmjet aktit nr.131/1 datë 10.02.2025 “*Transferim për shkak të ristrukturimit*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist i Arsimit Parashkollor*”, në Sektorin e Arsimit Parashkollor, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve;
 10. Indrit Torba, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 15167 prot., datë 02.10.2023, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Mbikëqyrjes dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastruktures, Transportit dhe Mjedisit;
 11. Endri Pacaj, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 2914 prot., datë 13.03.2023, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist PAK dhe Njesisë së Mbrojtjes Fëmijëve*”, në Njësia Administrative Shëngjin;
 12. Edlira Frroku, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 1759 prot., datë 12.02.2024, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist i Bujqësisë, Pyjeve dhe Ujitjes*”, në Njësia Administrative Kolsh;
 13. Erjona Gaspri, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 16890, datë 09.11.2023, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin “*Specialist i Ndhmës Ekonomike, Pak dhe Njesisë së Mbrojtjes Fëmijëve*”, në Njësia Administrative Blinisht.
- Ndërsa, për punonjësit e evidentuar më poshtë, me akt të njësisë përgjegjëse, janë emëruar si “*nëpunës civil në periudhë prove*”, por nga këqyrja e dosjes së personelit, rezulton se, *mungojnë aktet që duhet të nxirren gjatë periudhës së provës*, si dhe *nuk i është deklaruar statusi si “nëpunës civil”*. Bëhet fjalë për punonjësit:
1. Anilda Memaj, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 13692 prot., datë 30.07.2020, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin

- “Specialist për Shpenzimet”*, në Sektorin e Kontabilitetit, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit;
2. Marinela Markaj, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 11397 prot., datë 17.07.2020, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin *“Specialist për Hartimin e Pagave dhe Ndihmën Ekonomike”*, në Sektorin e Hartimit, Zbatimit të Buxhetit dhe Pagave, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit dhe transferuar nëpërmjet aktit nr.2617/1 datë 25.03.2022 *“Transferim për shkak të ristrukturimit”*, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin *“Specialist për Kontabilitetin”* në Sektorin e Kontabilitetit, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit;
 3. Rovena Arapi, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 11399 prot., datë 17.07.2020, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin *“Specialist për Magazinën dhe Inventarët”*, në Sektorin e Kontabilitetit, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit;
 4. Imelda Kola, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 11396 prot., datë 17.07.2020, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin *“Specialist për Hartimin e Pagave”*, në Sektorin e Hartimit, Zbatimit të Buxhetit dhe Pagave, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit;
 5. Dorina Ndreu, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 8947 prot., datë 23.05.2022, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin *“Specialist i Kontrollit Ushqimor”*, në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit, Kontrollit Veterinar dhe Ushqimor, në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve;
 6. Esmerilda Pali, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 17048 prot., datë 21.09.2020, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin *“Specialist i Ndihmës Ekonomike, PAK dhe Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve”*, në Njësinë Administrative Kallment;
 7. Klara Braho, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 1310 prot., datë 27.01.2021, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në pozicionin *“Specialist i Bujqësisë, Pyjeve dhe Ujitjes”*, në Njësinë Administrative Kallment.

Rezulton se, për të gjithë nëpunësit si më sipër, **ka mbaruar afati 1 vjeçar i periudhës së provës**, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, e cila nis nga data e aktit të emërimit.

Në lidhje me këtë konstatim, nga observacionet e institucionit, si dhe nga aktet e dërguara, rezulton se, për nëpunësit: **Anilda Memaj, Marinela Markaj, Rovena Arapi dhe Imelda Kola**, janë nxjerrë aktet e konfirmimit nga eprori direkt; aktet e deklaramentit të statusit *“nëpunës civil”* nxjerrë nga njësia përgjegjëse; kanë marrë në përfundim të trajnimit të detyrueshëm certifikatën pranë ASPA-s; si dhe janë kryer vlerësimet e rezultateve individuale në punë, për periudhën e provës 1 vjeçare duke përmbyllur në këtë mënyrë periudhën e provës për nëpunësit të emëruar për herë të parë në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil, në zbatim të kreut VI, pika 13, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar.

Gjatë verifikimit të veprimeve administrative në lidhje me zbatimin e kërkesave ligjore të periudhës së provës, pas këqyrjes së akteve, rezultoi se:

- Nëpunësit Merita Salihi, Bruno Sherri, Erestina Ndoka, Robert Prenga, Stelina Shabi, Anilda Memaj, Marinela Markaj, Rovena Arapi dhe Imelda Kola **kanë kryer** ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA dhe në përfundim të tij janë vlerësuar me pikë, ku kanë marrë mbi 50% të pikëve; nëpunësit **janë vlerësuar** për rezultatet individuale në punë, për periudhën e provës 1 vjeçare; është nxjerrë akti i konfirmimit nga eprori direkt; dhe në përfundim **është nxjerrë** nga njësia përgjegjëse akti i deklaramit të statusit për secilin nëpunës. Nga verifikimi i dokumentacionit të periudhës së provës, konstatohet se, në të gjitha rastet, **nuk është caktuar nëpunësi civil më i vjetër në detyrë dhe si rezultat, mungon mendimi me shkrim i tij**, udhëzimet e të cilit duhet të ndjekë nëpunësi civil në periudhë prove, si një element i rëndësishëm ligjor që shoqëron vendimmarrjen e eprorit direkt.
- Ndërsa për **11** nëpunësit civil Fation Noka, Ndue Gega, Aurel Locaj, Ornela Simoni, Indrit Torba, Endri Pacaj, Edlira Frroku, Erjona Gaspri, Dorina Ndreu, Esmerilda Pali dhe Klara Braho për të cilët ka mbaruar periudha e provës, rezultoi se:
 - ✓ Në të gjitha rastet, nëpunësit **nuk e kanë kryer** ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike(ASPA), me përjashtim të nëpunësit Fation Noka;
 - ✓ **Mungon** mendimi me shkrim i nëpunësit civil më të vjetër në detyrë, udhëzimet e të cilit duhet të ndjekë nëpunësi civil në periudhë prove, detyrim që rrjedh nga pika 2/b dhe pika 4, e Kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015.
Caktimi i nëpunësit mbikëqyrës, është një detyrim ligjor që eprori direkt dhe njësia përgjegjëse, duhet ta ketë në vëmendje për ta zbatuar në vijimësi. Kjo kërkesë ligjore nuk është një formalizëm, por është një moment i rëndësishëm për të siguruar ecurinë normale dhe përshtatjen e nëpunësit në periudhë prove me natyrën e institucionit dhe të pozicionit të tij të punës;
 - ✓ **Mungojnë** formularët e vlerësimit të rezultateve individuale në punë, për periudhën e provës;
 - ✓ **Mungon** vendimi i konfirmimit ose jo në shërbimin civil, për nëpunësin, nga eprori direkt, detyrim i cili lind nga pika 7, e Kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, ku parashikohet se mosrealizimi i procedurës së përcaktuar në këtë pikë të VKM, brenda afatit 15 ditësh kalendarike, konsiderohet “*mospërmbyllje detyre*” për eprorin direkt (pika 8 e VKM - së, së mësipërme);
 - ✓ Së fundmi, **mungon** deklarimi i statusit të nëpunësit civil, si veprim që duhet të kryhet në bazë të pikës 13, të kreut VI, “*Periudha e provës*”, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin , lëvizjen paralele , periudhën e provës, dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.

Konkluzion: Sa më sipër, përse i përket **15 rasteve** të nëpunësve për të cilët ka përfunduar periudha e provës, eprori direkt nuk e ka kryer detyrën, për sa kohë që rezultoi se **munqon vendimi nga ana e tij**, për finalizimin e periudhës së provës, detyrim i cili lind nga pika 7, e Kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”. Në këtë dispozitë parashikohet se mosrealizimi i procedurës së përcaktuar në këtë pikë të VKM, brenda afatit 15 ditësh kalendarike, konsiderohet “*mospërmbyllje detyre*” për eprorin direkt (pika 8 e VKM - së, së mësipërme);

Nga ana tjetër, vendimi i eprorit direkt për konfirmimin e nëpunësit civil, duhet të bazohet në çdo rast në vlerësimin e rezultateve individuale në punë, për gjithë periudhën e provës. Ndërkohë, procesi i vlerësimit të punonjësit në periudhë prove, kryhet sipas VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 109, datë 26.2.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, ç’ka në rastin konkret nuk është respektuar.

Në këtë rast, duke mos përmbyllur procedurën e vlerësimit të punës për periudhën e provës, njësia e burimeve njerëzore dhe zyrtari respektiv, **nuk kanë kryer** një nga detyrat më të rëndësishme që duhet të realizohen gjatë periudhës së provës, që është hartimi dhe nënshkrimi i formularit të vlerësimit të punës.

Ndërkohë, njësia përgjegjëse (njësia e burimeve njerëzore në institucion), në zbatim të pikës 13, të kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, duhet të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit të vendimit të konfirmimit nga eprori direkt.

Për të gjitha sa analizuam më sipër, si dhe mbështetur në parashikimet e nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në kreun VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, sjellim në vëmendje të aktorëve përgjegjës (eprorit direkt; zyrtarëve vlerësues dhe njësisë përgjegjëse), me qëllim finalizimin e procesit të periudhës së prove, për të gjithë nëpunësit civilë në periudhë prove, se nga ana e tyre duhet të përmbyllin këto detyra ligjore:

- Eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove, **duhet të caktojë nëpunësin më të vjetër**, nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove, të bëjë vlerësimin e rezultateve individuale në punë për periudhën e provës dhe vendimin për përfundimin e periudhës së provës. Vlerësimi i rezultateve individuale në punë për periudhën e provës, bëhet sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore. Në rastin e vlerësimit për periudhën e provës, periudha e vlerësimit fillon nga data e aktit të emërimit dhe zgjat një vit. Për këtë arsye, në formularin e vlerësimit të

punës, në “Ndarja A”, duhet të përzgjidhet rasti “Tjetër (specifiko)”, duke shënuar “Vlerësim i rezultateve në punë për periudhën e provës”.

- Eprori direkt duhet që, në çdo rast, vendimin e konfirmimit të nëpunësit civil t’ia njoftojë njësisë përgjegjëse (*njesisë së burimeve njerëzore të institucionit*), e cila në zbatim të pikës 13, të kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, **nxjerr aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike**, nga data e njoftimit të vendimit të konfirmimit nga eprori direkt.
- Të administrohet në dosjen e personelit vendimi i konfirmimit; akti i vlerësimit të punës, ku të jenë plotësuar në mënyrë të saktë dhe të qartë të gjitha të dhënat që kërkohen në ndarjet e formularit, përfshirë edhe komentet përkatëse për ecurinë e punës së nëpunësit të vlerësuar dhe nënshkrimin e të gjithë zyrtarëve të vlerësimit dhe të nëpunësit të vlerësuar, në të gjitha rubrikat e nevojshme, si dhe mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit duhet të ndjekë nëpunësi gjatë periudhës së provës.

III/2 Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese dhe respektimi i procedurave të kërkuara nga neni 26, i ligjit për nëpunësin civil.

Bazuar në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të ligjit për nëpunësin civil, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, *së pari*, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, *së dyti*, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë.

Rregullat që duhet të ndjekë njësia përgjegjëse për organizimin e procedurës së konkurrimit për këto raste, janë të parashikuara në nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil, në kreun II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, si dhe në kreun IV dhe V, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Komisioneri verifikoi të gjitha veprimet procedurale të kryera nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Lezhë dhe Komisioni Pranimi për Ngritje në Detyrë për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, për procedurën e ngritjes në detyrë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se, për periudhën Janar–Dhjetor 2024, janë realizuar 7 procedura konkurrimi për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, si më poshtë:

- 3 procedura janë realizuar nëpërmjet ngritjes në detyrë; dhe

- **4** procedura janë realizuar nëpërmjet ngritjes në detyrë me pjesëmarrjen e nëpunësve të tjerë, që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Konstatohet se, shpalljet e procedurave të konkurrimit, për periudhën objekt mbikëqyrjeje, janë publikuar në portalin “*Agjencia Kombëtare i Punësimit dhe Aftësive*”, si dhe faqen e internetit të institucionit, sipas rregullave të përcaktuara në pikat 3 deri në 7, të kreut II, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015, i ndryshuar.

- ✓ **Procesi i plotësimit të pozicioneve të kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, me kandidatë nëpunës civilë dhe rastet kur procesi ka qenë i hapur edhe për kandidatë të tjerë, që nuk janë pjesë e këtij sistemi.**

Rregullat procedurale për të plotësuar pozicionet e punës në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues (lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë), janë të parashikuara në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, si dhe Vendimin nr.242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”.

Sipas përcaktimeve të mësipërme ligjore, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari, nga nëpunësit civil të së njëjtës kategori, nëpërmjet *procedurës së lëvizjes paralele*, e nëse me anën e kësaj procedure pozicionet e lira nuk plotësohen, atëherë vijon procedura për plotësimin e vendeve të lira me *procedurën e ngritjes në detyrë*.

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton se, për periudhën objekt mbikëqyrjeje, Janar - Dhjetor 2024, nga njësia përgjegjëse e institucionit të Bashkisë Lezhë, janë zhvilluar dhe kanë përfunduar me fitues **7** procedura konkurrimi, për plotësimin e **7** pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, nga këto:

- ❖ **3** procedura kanë përfunduar me procedurë ngritje në detyrë, nga punonjës pjesë e shërbimit civil brenda institucionit, bëhet fjalë për punonjësit e emëruar në këto pozicione pune:
 1. Erin Pepkolaj, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Verifikimit dhe Kontrollit në Terren të Tatimpaguesve, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-2;
 2. Denis Përvathi, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Verifikimit dhe Kontrollit në Terren të Tatimpaguesve, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-a;
 3. Denis Përvathi, emëruar në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria II-b.

Nga këqyrja e materialeve rezulton se, në të gjitha rastet e ngritjes në detyrë, nga kandidatë të brendshëm, kandidatët që kanë aplikuar për procedurën e konkurrimit, i plotësojnë kushtet minimale dhe kërkesat e veçanta sipas shpalljes për konkurrim, të përcaktuara në pikën 2, të kreut III, të aktit nënligjor, të cilat janë si më poshtë:

- Janë nëpunës civilë të konfirmuar, me kategori page sipas përcaktimit në shpallje, e vërtetuar në të gjitha rastet me aktet përkatëse të konfirmimit të statusit;
- Nuk kanë masë disiplinore në fuqi;
- Janë administruar vlerësimet e punës për periudhën e fundit, sipas formatit të vlerësimit, të nënshkruar nga nëpunësit pjesëmarrës në vlerësim.
- Gjithashtu, bazuar në planin vjetor të pranimi, si dhe nevojat që kanë lindur gjatë vitit kalendarik, njësia përgjegjëse ka shpallur procedurat e konkurrimit për çdo pozicion, duke bërë të njohur edhe planin e zhvillimit të procedurës. Shpallja e procedurës së konkurrimit për secilin pozicion është bërë në portalin “AKPA” dhe në faqen e internetit të institucionit, sipas rregullave të përcaktuara në pikat 3 - 7, të kreut II, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015, i ndryshuar.

Në vijim, mbështetur në pikën 4 dhe 6, të kreut III, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015, konstatohet se, është respektuar në të gjitha rastet afati prej 35 ditësh kalendarike për shpalljen e procedurës së konkurrimit me ngritje në detyrë, si dhe afati prej 15 ditësh kalendarike për dorëzimin e dokumentacionit nga kandidatët e interesuar për këtë procedurë.

- ✓ Konkurrimi për procedurën e ngritjes në detyrë, sipas pikës 21, të kreut III, përfshin dy faza:
 - a) Verifikimin paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
 - b) vlerësimin e kandidatëve.

Njësia përgjegjëse (*Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse*), në bazë të dokumentacionit të paraqitur, ka kryer verifikimin paraprak të aplikantëve me qëllim verifikimin nëse ata i plotësojnë ose jo kushtet e ngritjes në detyrë dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpallje. Procedurat e verifikimit të kandidatëve janë kryer jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimi të tyre, afat ky i parashikuar në pikën 22, të kreut III, të VKM nr. 242, dt. 18.3.2015.

Për çdo procedurë të realizuar, lista paraprake me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta të pozicionit të punës është shpallur në portalin “AKPA” dhe në faqen e internetit të institucionit. Në të gjitha rastet për këtë procedurë kanë aplikuar nëpunës të një kategorie paraardhëse të punësuar në administratën e bashkisë (nëpunës nga brenda institucionit të mbikëqyrur).

- ✓ *Vlerësimi i kandidatëve nga Komiteti i Pranimi për Ngritje në Detyrë (KPND)*

Për të realizuar fazën e dytë të konkurrimit, që është faza e vlerësimit të kandidatëve, mbështetur në parashikimet e pikës 6, të nenit 26, të ligjit për nëpunësin civil, njësia përgjegjëse ka ngritur Komitetin e Pranimi për Ngritje në Detyrë (KPND).

KPND është ngritur me 5 (pesë) anëtarë, është kryesuar nga njësia përgjegjëse dhe në përbërje ka patur një anëtar të zgjedhur nga titullari, midis nëpunësve civilë të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të institucionit, eprorin direkt të vendit të punës për të cilin është organizuar konkurrimi dhe dy ekspertë të fushës. Në caktimin e anëtarëve të këtij organi kolegjal janë mbajtur parasysh parashikimet e pikës 7, të kreut III, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015, i ndryshuar dhe në të gjitha rastet KPND i ka marrë vendimet në praninë e të gjithë anëtarëve të tij.

- Në testimin me shkrim dhe me gojë të kandidatëve, KPND ka bërë vlerësimin e kandidatëve:
 - a) Jetëshkrimin, vlerësimi maksimal 20 pikë. *(Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e arsimit, përvojës e trajnimeve, të lidhura me fushën si dhe vlerësimin e arritjeve individuale në punë).*
 - b) testimin me shkrim, vlerësimi maksimal 40 pikë;
 - c) Intervistën e strukturuar me gojë, vlerësimi maksimal 40 pikë.

Për kryerjen e vlerësimit me shkrim të kandidatëve, anëtarët e KPND kanë përgatitur testet përkatëse. Në të gjitha rastet **nuk është hartuar çelësi i përgjigjeve.**

Testet përmbajnë pyetje me alternativa. Pyetjet me alternativa janë hartuar sipas rregullave të përcaktuara në pikën 1, të ndarjes V/5, të udhëzimit të DAP, si dhe brenda fushës së njohurive dhe aftësive, kompetencave, mbi të cilat do të zhvillohet testimi, të përfshira në shpalljen për konkurrim. Anëtarët e KPND kanë korrigjuar testet dhe kanë vlerësuar kandidatët duke dhënë pikët për secilin.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se, në vlerësimin me shkrim, anëtarët e KPND, kanë zbatuar rregullat e pikës 8, të paragrafit III/6, të udhëzimit të DAP, duke pjestuar shumën totale të pikëve me pesë *(në bazë të numrit të vlerësuesve)*.

Në përfundim të këtij testimi, si dhe të vlerësimit të jetëshkrimit *(i cili është bërë sipas modelit të vlerësimit në Aneksin nr.7, bashkëlidhur udhëzimit të DAP)*, kanë rradhitur kandidaturat *(në rastet kur ka patur më shumë se një)*, të cilët janë kualifikuar për fazën e intervistës me gojë.

- Në lidhje me intervistën me gojë, gjatë procedurës së ndjekur nga KPND, rezulton se:
 - Në të gjitha rastet **mungon** lista e pyetjeve për intervistën me gojë.
 - Në të gjitha rastet **mungon** procesverbali intervistës së strukturuar me gojë.
 - Brenda afateve të parashikuara, KPND ka zhvilluar intervistën me gojë me secilin nga kandidatët dhe më pas ka hartuar raportin e procedurës së zhvilluar duke bërë vlerësimin, i cili, sipas udhëzimit të DAP, është i njëjtë me atë të lëvizjes paralele, por shuma totale, në këtë rast, pjesëtohet me pesë *(numri i vlerësuesve)*.
 - Në të gjitha rastet, kandidatët **kanë** nënshkruar deklaratat e mospranimi për të regjistruar intervistën me gojë.
 - Rezulton që anëtarët e KPND, në të gjitha rastet, **kanë** nënshkruar deklaratën e paanësisë, për të deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim.

Në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, KPND ka hartuar raportin përfundimtar për rezultatin e konkurrimit.

Njësia e burimeve njerëzore, duke respektuar afatet që përcaktojnë aktet ligjore e nënligjore, ka shpallur fituesit në portalin “AKPA” dhe në faqen zyrtare të institucionit; njëkohësisht ka dalë edhe akti i emërimit nga Drejtori Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Në të gjitha rastet konkurrenti fitues, në vlerësimin përfundimtar ka marrë më shumë se 70 pikë (*mbi 70% të pikëve*). Raporti përfundimtar i vlerësimit dhe i gjithë dokumentacioni i fazës së vlerësimit i janë dorëzuar njësisë përgjegjëse e cila e ka administruar në mënyrë të rregullt këtë dokumentacion.

- ✓ Emri i kandidatit fitues është shpallur në portalin “AKPA”, në faqen e internetit të institucionit dhe në stendat e informimit të publikut.
- ✓ Njësia përgjegjëse ka përmbyllur procedurën e ngritjes në detyrë duke ftuar fituesin që të japë miratimin për pozicionin për të cilin ka konkurruar. Në të gjitha rastet kandidatët fitues kanë dhënë me shkrim miratimin e tyre se e pranojnë pozicionin e punës.
- ❖ 4 procedura kanë përfunduar nëpërmjet ngritjes në detyrë me **me kandidatë të tjerë, që nuk janë pjesë e shërbimit civil**, bëhet fjalë për kandidatët fitues të emëruar në pozicionet:
 1. *Alda Prendi*, emëruar në pozicionin “Përgjegjës”, në Sektorin e Funksioneve Mbështetëse, në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, kategoria III-a/1;
 2. *Ildi Dosti*, emëruar në pozicionin “Përgjegjës”, në Sektorin e Mbledhjes dhe Menaxhimit të Borxhit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, kategoria III-a;
 3. *Marte Fetaj*, emëruar në pozicionin “Drejtör”, në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social, kategoria II-b;
 4. *Nikolin Shtjefni*, emëruar në pozicionin “Drejtör”, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, kategoria II-2.

Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në pikën 4, të nenit 26, parashikohet se, procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese mund të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë, nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira. Në çdo rast plotësimi i vendeve të lira në këtë kategori nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.

Nëpërmjet këtij rregulli përjashtues, një numër i kufizuar pozicionesh të cilat normalisht do të ishin të hapura për konkurrim vetëm për nëpunësit civil, hapen edhe për kandidatë nga jashtë, nëse procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë rezultojnë pa fitues. Ky numër duhet specifikuar qartë në planin e rekrutimit.

Gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, për këto pozicione, nga njësia përgjegjëse e institucionit, në përgjithësi ka bërë përpjekje për të përmbushur rregullat e përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, Vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në

- ✓ Në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, konstatohet se:

Së pari, sipas përcaktimeve në aktin ligjor e nënligjor, plotësimi i vendeve të lira të kategorisë së ulët e të mesme drejtuese, me kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, bëhet me vendim të titullarit të institucionit.

Në rastin konkret, nga verifikimi i mëtejshëm, rezulton se, procedurat e konkurrimit për pozicionet e mësipërme, janë përfshirë në planin vjetor të pranimeve në shërbimin civil, gjithashtu me aktin nr. 63 (nr.803 prot.), datë 21.01.2024, “Për miratimin e pozicioneve të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese të cilat do të jenë të hapura për konkurrim dhe për pranim nga jashtë shërbimit civil”, të titullarit të institucionit, **janë përcaktuar pozicionet e punës të cilat janë të hapura për të plotësuar edhe me kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil** që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lirë, për të cilën kemi folur edhe më sipër në material.

Së dyti, numri i vendeve të lira të kategorisë së ulët e të mesme drejtuese, që do të plotësohen me kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik. Nga verifikimi rezulton se, numri i pozicioneve të punës, për këtë procedurë, që janë plotësuar me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, **nuk e ka tejkaluar numrin sipas përcaktimeve të ligjit**.

Konkluzion: Komisioneri konstaton se, procedurat e konkurrimit, të zhvilluara nëpërmjet ngritjes në detyrë/ pranim nga jashtë shërbimit civil, për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, janë zhvilluar në zbatim të rregullave të parashikuara në nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil, kreun III, të VKM nr.242, datë 18.3.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, si dhe kreun V, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

III/3. Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese.

Përsa i përket pranimin të nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese, rezulton se, nga analiza e të dhënave të mbledhura gjatë procesit të mbikëqyrjes, për periudhën Janar - Dhjetor 2024, nga

njësia përgjegjëse e institucionit të Bashkisë Lezhë, **nuk është kryer** asnjë procedurë konkurrimi për plotësimin e pozicioneve të kategorisë së nivelit të lartë drejtues.

IV. Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të cilat rezultojnë të jenë të plotësuara me emërim në kundërshtim me ligjin.

Bazuar në strukturën dhe organikën që është në fuqi në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, në Bashkinë Lezhë rezultojnë të jenë **të zëna me emërim në kundërshtim me ligjin 34 pozicione të shërbimit civil**. Konkretisht, bëhet fjalë për: **17** pozicione të nivelit ekzekutiv; **12** pozicione të nivelit të ulët drejtues dhe **5** pozicione të nivelit të mesëm drejtues, nga punonjësit dhe me aktet si më poshtë:

A. Emërim në kundërshtim me ligjin në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues

1. **Altin Lleshi**, emëruar në pozicionin “Drejtor”, në Drejtorinë Juridike, me aktin nr. 112, datë 07.02.2024 (nr. 1880 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
2. **Flamur Kuçi**, emëruar në pozicionin “Drejtor”, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, me aktin nr. 459, datë 01.12.2023 (nr. 17835 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
3. **Gjek Makaj**, emëruar në pozicionin “Drejtor” në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, me aktin nr. 153, datë 11.03.2024 (nr. 3234 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
4. **Paulin Gjergji**, emëruar në pozicionin “Drejtor”, në Drejtorinë e Emergjencave Civile, me aktin nr. 418, datë 02.09.2024 (nr. 14425 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
5. **Vasilika Laska**, emëruar në pozicionin “Drejtor”, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, me aktin nr. 170, datë 18.03.2024 (nr. 9432 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
6. **Arjan Barbullushi**, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, me aktin nr. 516, datë 19.09.2022 (nr. 15545 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
7. **Alban Laci**, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Ndjekjes dhe Zbatimit të Kontratave, në Drejtorinë Juridike, me aktin nr. 580, datë 04.11.2024 (nr. 17802 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
8. **Albana Nikolli**, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, me aktin nr. 471, datë 02.12.2021 (nr. 20545 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
9. **Arjeta Pati**, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Protokoll Arkivës, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, me aktin nr. 323, datë 25.06.2024 (nr. 11387 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
10. **Donika Uku**, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Pronave, në Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës, me aktin nr.414, datë 25.07.2022 (nr. 13300 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
11. **Ylli Perndreca**, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Kadastrës dhe Rregjistrimit të Aseteve, në Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës, me aktin nr.201, datë 01.04.2022 (nr. 4519 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.

12. **Zhaneta Frroku**, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Legalizimit të Ndërtimeve pa Leje, në Drejtorinë e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës, me aktin nr.437, datë 10.09.2024 (nr. 14829 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
13. **Arlinda Marku**, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës Sektori (Specialiste e Integritit)*”, në Drejtorinë e Integritit dhe Strategjive të Zhvillimit, me aktin nr. 91, datë 04.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë. Aktualisht rezulton “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Programimit Zhvillimit, Komunikimit dhe Transparencës, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës.
14. **Altin Përgjegji**, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës Sektori*”, në sektorin e Arsimit Parauniversitar, Rinisë dhe Sporteve, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, me aktin nr. 109, datë 02.02.2022 (nr. 1406 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
15. **Klodjana Rakaj**, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Arsimit Parashkollorë, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, me aktin nr. 526, datë 28.12.2023 (nr. 18989 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
16. **Emanuela Nikolli**, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Promovimit të Turizmit dhe Kulturës, në Drejtorinë Turizmit dhe Kulturës, me aktin nr. 570, datë 29.12.2023 (nr. 19101 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
17. **Paulin Lushaj**, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, me aktin nr.66, datë 25.01.2024 (nr. 963 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.

Konstatim: Komisioneri konstaton se, akti i emërimit, për punonjësit e evidentuar më sipër, ka dalë **në kundërshtim me ligjin**, pasi, nuk janë respektuar kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi, sipas përcaktimeve të nenit 26 të ligjit 152/2013 dhe VKM nr. 242, datë 18.3.2015 “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.

B. Emërimet në kundërshtim me ligjin në nivelin ekzekutiv

1. **Leonard Dushaj**, emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Sektorin e Ndjekjes dhe Zbatimit të Kontratave, në Drejtorinë Juridike, me aktin nr. 623, datë 26.11.2024 (nr. 18960 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
2. **Enkeled Marku**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren*”, në Sektorin e Verifikimit dhe Kontrollit në Terren të Tatimpaguesve, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, me aktin nr. 544, datë 10.10.2024 (nr. 16484 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
3. **Eda Hasani**, emëruar në pozicionin “*Specialist Kontabiliteti*”, në Sektorin e Kontabilitetit, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, me aktin nr. 433, datë 10.09.2024 (nr. 14827 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
4. **Adelajda Ndoka**, emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Sektorin e Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, me aktin nr. 574, datë 29.12.2023 (nr. 19105 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.

5. **Elona Gjonaj**, emëruar në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, me aktin nr.11, datë 12.01.2023 (nr. 911 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
6. **Emanuela Ndoja**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Ndihmës Ekonomike*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Pak, në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me aktin nr.473, datë 23.09.2024 (nr. 15470 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
7. **Desara Marku**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Mbrojtjes së Femijëve*”, në Sektorin e Kujdesit Social dhe Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me aktin nr. 345 datë 09.07.2024 (nr. 12264 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
8. **Erleta Pjetri**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Mbrojtjes së Femijëve*”, në Sektorin e Kujdesit Social dhe Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me aktin nr. 370 datë 26.07.2024 (nr. 12947 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
9. **Zef Doçi**, emëruar në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Emergjencave Civile, në Drejtorinë e Emergjencave Civile, me aktin nr. 443 datë 11.09.2024 (nr. 14920 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
10. **Pjeter Toni**, emëruar në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Emergjencave Civile, në Drejtorinë e Emergjencave Civile, me aktin nr. 451 datë 16.09.2024 (nr. 15110 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
11. **Xhesika Sherri**, emëruar në pozicionin “*Specialist Finance*”, në Sektorin e në Arsimit Parauniversitar, Rinisë dhe Sporteve, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, me aktin nr. 598 datë 7.11.2024 (nr. 18045 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
12. **Denisa Preçi**, emëruar në pozicionin “*Specialist Psikolog*”, në Sektorin e në Arsimit Parashkollor, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, me aktin nr. 425 datë 06.09.2024 (nr. 14673 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
13. **Nesida Palokaj**, emëruar në pozicionin “*Specialist Mjedisit*”, në Sektorin e Infrastrukturës, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, me aktin nr.432 datë 10.09.2024 (nr. 14825 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
14. **Kreshnik Pjetri**, emëruar në pozicionin “*Specialist Supervisor për Dekorin/ Gjellbërmin/Varrezat dhe Punët Publike*”, në Sektorin e Mbikëqyrjes së Shërbimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, me aktin nr.189 datë 03.04.2024 (nr. 4027 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
15. **Ervis Sela**, emëruar në pozicionin “*Specialist IT*”, në Sektorin e i Programimit të Zhvillimit, Komunikimit dhe Transparencës, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, me aktin nr. 110, datë 02.02.2022 (nr. 1407prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
16. **Romina Smaci**, emëruar në pozicionin “*Specialist i Bujqësisë, Pyjeve dhe Ujitjes*”, në Njeshinë Administrative Zejmen, me aktin nr. 672, datë 20.12.2024 (nr. 20137 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.
17. **Genisërdo Përdoda**, emëruar në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Dhënies dhe Monitorimit të Lejeve Zhvillimore, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, me aktin nr. 665, datë 16.12.2024 (nr. 19921 prot.), të Kryetarit të Bashkisë.

Aktet e emërimit të evidentuara më sipër, si në rastin e administratës së bashkisë, ashtu edhe të njësive administrative, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimit. *Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.*

Vërejmë se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështirësi të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Lezhë duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe të konstatojë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë. Në momentin e shpalljes së konkurrimit, pozicionet që do të plotësohen, duhet të jenë efektivisht të lira.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV *“Pranimi në shërbim civil”*, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”* dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”*.

Në këtë rast Kryetari i Bashkisë Lezhë duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për **34 punonjësit** e emëruar në kundërshtim me ligjin, të evidentuar nominalisht në këtë pjesë të raportit dhe të rregullojë pasojat, me qëllim që në momentin e shpalljes së pozicionit të lirë të punës pranë AKPA, për tu plotësuar nëpërmjet konkurrimit, pozicioni të jetë efektivisht i lirë, për të respektuar në këtë mënyrë parimet e pranimit në shërbimin civil, ndër të cilat parimi i shanseve të barabarta dhe profesionalizmit.

Ky veprim do të rivendosë situatën e ligjshmërisë dhe do të mundësojë procesin e rekrutimit sipas kërkesave specifike që rregullojnë këtë institut të ligjit.

V. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore, kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të Disiplinës.

Në lidhje me pikën 10, të programit të mbikëqyrjes, *“Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore, duke filluar nga kërkesa për nisjen e ecurisë disiplinore, deri në marrjen e vendimit përfundimtar, sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe VKM nr.115, datë 5.3.2014”*, nga verifikimi i të gjitha akteve administrative të vëna në dispozicion nga njësia e burimeve njerëzore, u konstatua se, për periudhën objekt mbikëqyrje, në subjektin e kontrolluar **nuk u konstatuan raste** të tilla.

Për sa i takon funksionimit të një prej organeve të disiplinës, që është Komisioni i Disiplinës, nga verifikimi i dokumentacionit dhe sipas sqarimeve të dhëna nga njësia përgjegjëse, rezulton se ai **nuk është ngritur pranë këtij institucioni**, ashtu si kërkohet në pikat 2 dhe 3 të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Për këtë arsye me qëllim që të funksionojë ky organ i rëndësishëm i disiplinës përgjatë gjithë vitit kalendarik, njësia përgjegjëse duhet të veprojë, duke udhëhequr procesin për ngritjen e Komisionit të Disiplinës, duke përcaktuar në akt, nominalisht 3 aktorët e përhershëm të tij, sipas kërkesave të pikës 3, Kreun I, të Vendimit 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*, ndërkohë që 2 anëtarët e tjerë që përfaqësojnë eprorin direkt të nëpunësit të proceduar dhe nëpunësin më të vjetër në njësinë e këtij punonjësi, duhet të caktohen nominalisht rast pas rasti.

VI. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.

Përsa i përket përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit gjatë periudhës objekt mbikëqyrje, në Bashkinë Lezhë, rezulton se kanë përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil, punonjësit e evidentuar si më poshtë:

1. **Rozeta Lleshi**, me detyrë “*Specialist i Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve*”, në Njësinë Administrative Zejmen, me Vendimin nr. 19799/1 prot., datë 16.12.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 19799 prot., datë 13.12.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.
2. **Anduela Cakoni**, me detyrë “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Protokoll-Arkivit, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, me Vendimin nr. 11136/1 prot., datë 21.06.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 11136 prot., datë 21.06.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.
3. **Gerta Ujkaj**, me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Përputhshmërisë Ligjore, në Drejtorinë Juridike, me Vendimin nr. 5148/1 prot., datë 29.04.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 5148 prot., datë 29.04.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.
4. **Orjada Topalli**, me detyrë “*Specialist për Vlerësimin dhe Regjistrimin*”, në Sektorin e Regjistrimit dhe Vlerësimit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, me Vendimin nr.7058/1 prot., datë 17.05.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 7058 prot., datë 17.05.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.
5. **Lindita Fejzullahi (Frroku)**, me detyrë “*Specialist i Mbrojtjes së Fëmijëve*”, në Sektorin e Kujdesit Social dhe Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me Vendimin nr. 5256/1 prot., datë 02.05.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 5256 prot., datë 30.04.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.
6. **Majlinda Miloti**, me detyrë “*Specialist*”, në Drejtorinë e Emergjencave Civile, me Vendimin nr. 14758/1 prot., datë 10.09.2024, “*Për ndërprerjen e marrëdhënies të punës*”, të Kryetarit, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 14758 prot., datë 09.09.2024, në mbështetje të ligjit 139/2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*” dhe ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, është liruar nga kjo detyrë.
7. **Yllka Brahimi**, me detyrë “*Specialist i Ndhmës Ekonomike*”, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe Pak, në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me Vendimin nr. 15070/1 prot., datë 18.09.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 15070 prot., datë 16.09.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.

8. **Silvana Ndoj**, me detyrë “*Specialist Protokolli*”, në Sektorin e Protokoll-Arkivit, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, me Vendimin nr. 14965/1 prot., datë 12.09.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 14965 prot., datë 12.09.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.
9. **Blerta Pepkolaj**, me detyrë “*Specialist Finance*”, në Sektorin e Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, me Vendimin nr. 570/1 prot., datë 17.01.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 570 prot., datë 17.01.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.
10. **Mirela Pali**, me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Dhënies dhe Monitorimit të Lejeve Zhvillimore, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, me Vendimin nr.18492/1 prot., datë 15.11.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 18492 prot., datë 15.11.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.
11. **Mersida Deda**, me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Dhënies dhe Monitorimit të Lejeve Zhvillimore, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, me Vendimin nr.11833/1 prot., datë 05.07.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 11833 prot., datë 02.07.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.
12. **Klevis Marku**, me detyrë “*Specialist për Hartimin e Projekteve*”, në Sektorin e Hartimit të Projekteve, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, me Vendimin nr.6631/1 prot., datë 16.05.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së tij për dorëheqje, e protokolluar me nr. 6631 prot., datë 15.05.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.
13. **Orkida Jaku**, me detyrë “*Drejtor*”, në Drejtorinë Juridike, me Vendimin nr. 1485/1 prot., datë 06.02.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 1485 prot., datë 05.02.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.
14. **Denada Pjetrush**, me detyrë “*Specialist Protokolli*”, në Sektorin e Protokoll-Arkivit, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, me Vendimin nr. 4053/1 prot., datë 12.09.2024, “*Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare*”, të Kryetarit, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 4053 prot., datë 03.04.2024, në mbështetje të ligjit nr.152/2013, Vendimi nr. 243, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë*

- ekzekutive*”, i ndryshuar, shkresës nr. 1830 prot., datë 02.04.2024, me lëndë “*Emërim*”, të Departamentit të Administratës Publike, është liruar nga kjo detyrë.
15. **Manushage Hilej**, me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, me Vendimin nr. 18623/1 prot., datë 19.11.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 18623 prot., datë 18.11.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.
 16. **Alban Marku**, me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Dhënies dhe Monitorimit të Lejeve Zhvillimore, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, me Vendimin nr.712/1 prot., datë 22.01.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së tij për dorëheqje, e protokolluar me nr. 712 prot., datë 19.01.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.
 17. **Erinda Begu**, me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Dhënies dhe Monitorimit të Lejeve Zhvillimore, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, me Vendimin nr.18180/1 prot., datë 11.11.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 18180 prot., datë 11.11.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.
 18. **Enkeled Marku**, me detyrë “*Specialist Finance*”, në Sektorin e në Arsimit Parauniversitar, Rinisë dhe Sporteve, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, me Vendimin nr.16223/1 prot., datë 10.10.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së tij për dorëheqje, e protokolluar me nr. 16223 prot., datë 10.10.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.
 19. **Liza Ndoj**, me detyrë “*Specialist për Vlerësimin dhe Regjistrimin*”, në Sektorin e Regjistrimit dhe Vlerësimit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, me Vendimin nr. 300/1 prot., datë 13.01.2025, “*Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare*”, të Kryetarit, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 300 prot., datë 10.01.2025, në mbështetje të ligjit nr.152/2013, Vendimi nr. 243, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar, shkresës nr. 72 prot., datë 08.01.2025, me lëndë “*Emërim*”, të Departamentit të Administratës Publike, është liruar nga kjo detyrë.
 20. **Pjetër Gjini**, me detyrë “*Specialist i Bujqësisë, Ujitjes dhe Pyjeve*”, në Njësinë Administrative Bilisht, me Vendimin nr.1896/1 prot., datë 13.02.2024, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...*”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së tij për dorëheqje, e protokolluar me nr.1896 prot., datë 13.02.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.
 21. **Anisa Mollaj**, me detyrë “*Specialist i Rinisë*”, në Sektorin e Arsimit Parauniversitar, Rinisë dhe Sporteve, në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, me Vendimin nr.19922/1 prot.,

datë 20.12.2024, “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dorëheqjes...”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, sipas kërkesës së saj për dorëheqje, e protokolluar me nr. 19922prot., datë 16.12.2024, në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është liruar nga kjo detyrë.

Për 21 rastet e evidentuara më sipër, është aplikuar neni 64, “Dorëheqja”, i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi punonjësit kanë kërkuar miratimin e dorëheqjes nga pozicioni i punës pjesë e shërbimit civil.

Konstatohet se në këtë rast janë respektuar kërkesat e ligjit dhe njësia përgjegjëse ka vepruar në përputhje me to.

22. **Tonin Marku**, me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Mbledhjes dhe Menaxhimit të Borxhit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, me Vendimin nr. 3937 prot., datë 02.04.2024, “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të plotësimit të moshës për pension pleqërie...”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, dhe Urdhërit nr. 3986 prot, datë 02.04.2024, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare”, të Kryetarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare, për shkak të plotësimit të moshës për daljen në pension të plotë pleqërie.

23. **Hajri Kalaj**, me detyrë “Specialist Mjedisi”, në Sektorin e Infrastrukturës, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, me Vendimin nr. 12323 prot., datë 10.07.2024, “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të plotësimit të moshës për pension pleqërie...”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, dhe Urdhërit nr. 12323/1 prot, datë 11.07.2024, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare”, të Kryetarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare, për shkak të plotësimit të moshës për daljen në pension të plotë pleqërie.

Për shkak të plotësimit të moshës për pension të plotë pleqërie, në 2 raste, ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil dhe konstatohet se në këtë rast janë respektuar kërkesat e ligjit dhe njësia përgjegjëse ka vepruar në përputhje me to.

24. **Leonard Lesaj**, me detyrë “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Kulturës, në Drejtorinë e Turizmit dhe Kulturës, me Vendimin nr. 94 prot., datë 05.01.2024, “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit...”, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore, dhe Urdhërit nr. 94/1 prot., datë 08.01.2024, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare”, të Kryetarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare, për shkak të ristrukturimit.

Në këtë rast, për shkak të ristrukturimit të institucionit, i cili është një aspekt i përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, rezulton se në vitin 2024, punonjësi është liruar nga shërbimi civil.

VII. Dosja e personelit

Gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucion në lidhje me zbatimin e kërkesave të ligjit për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, u konstatua se, dokumentacioni i verifikuar, në këtë rast, administrohet edhe në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil.

Të dhënat, të cilat kanë të bëjnë me përvojën në punë, fillimin e marrëdhënieve të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*), diplomën e arsimit të lartë që kërkon pozicioni i punës (*nivelin e diplomës dhe fushën e studimeve univeristare*), si dhe plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, janë paraqitur në Tabelën nr.1 dhe 2, bashkëlidhur raportit.

Nga këto të dhëna rezulton se, në institucionin e Bashkisë Lezhë, në momentin e mbikëqyrjes janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil 173 punonjës, ku, 100 punonjës janë femra dhe 73 punonjës janë meshkuj.

Përsa i përket arsimit, konstatohet se, 134 nëpunës kanë kryer arsimin e lartë në institucione arsimore publike dhe 39 nëpunës kanë kryer arsimin e lartë në institucione arsimore private.

Konkluzion: Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se dosjet e personelit janë të rregullta, të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore, që është edhe njësia përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore për institucionin.

*
* *

Këto ishin rrethanat e konstatuara nga Komisioneri gjatë procesit të mbikëqyrjes në Bashkinë Lezhë, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, e në vijim.

Aktet administrative që dokumentojnë procesin e mbikëqyrjes në këtë institucion, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat si më poshtë:

- Tabela nr.1: “*Nëpunës të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, në Bashkinë Lezhë*”;

- Tabela nr.2: “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes, janë të emëruar në pozicione të shërbimit civil”.

Këto tabela i bashkëlidhen raportit, si pjesë e tij.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha